

1 E hënë, 23 shtator 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Thaçi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.01

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
8 paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
14 faleminderit.

15 Vërej që me përjashtim të z. Thaçi, që na ndjek përmes
16 videolidhjes, të akuzuarit e tjerë janë të pranishëm në sallën
17 e gjyqit.

18 Para se të vijë dëshmitari, dua të trajtoj një aspekt
19 paraprak.

20 Për arsye që janë përtej kontrollit tonë, do të duhet të
21 ndryshojmë pak orarin për të enjten, 26 shtator 2024. Do ta
22 bëjmë pushimin e drekës nga ora 1.00 deri në 2.00, jo nga ora
23 1.00 deri në 2.30 dhe pasditen do e fillojmë në orën 2.00 dhe
24 do ta mbarojmë në orën 3.00. Pra, ditën e enjte do të
25 përfundojmë në orën 3.00. Ky ishte ndryshimi.

1 Tani do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
2 Prokurorisë 03885.

3 Ju lutem, silleni dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
6 Dëshmitar.

7 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A na dëgjoni
9 mirë?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistentja e
12 seancës do t'ju japi betimin solemn. Këtë betimin duhet ta
13 bëni në bazë të rregullores së Gjykatës paragrafi 2 i
14 Gjykatës, neni 141. Lexojeni tekstin përpara me zë të lartë.

15 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
16 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
17 them të vërtetën dhe krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën
18 dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

19 DËSHMITARI: DEMUSH KRASNIQI

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 uleni. Tani mund të uleni, Dëshmitar.

22 Dëshmitar, sot do fillojmë me dëshminë tuaj që do
23 mendohet se do të zgjasë vetëm gjysëm dite. Në fillim pyetjet
24 do t'i bëjë Prokuroria, më pas mund t'ju bëjnë pyetje dhe
25 ekipet e Mbrojtjes. Por edhe Gjykatësit mund të kenë pyetje

1 për ju.

2 Prokuroria ka kërkuar gjysëm ore për t'ju bërë pyetje.

3 Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar dy orë e 30 minuta. Inkurajoj
4 të gjitha palët të jenë sa më të kujdesshëm në shfrytëzimin e
5 kohës së tyre. Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje plotësuese
6 nëse përmbushen kushtet përkatëse.

7 Dëshmitar, përgjigjuni qartë me fjali të shkurtra. Nëse
8 nuk kuptoni një pyetje, lirisht kërkonit që pyetja të
9 përsëritet ose thjesht thoni që nuk e kuptoni. Gjithashtu na
10 thoni ku i bazoni ju faktet, rrethanat për të cilat do t'ju
11 bëjnë pyetje.

12 Në qoftë se Prokuroria ju kërkon të përmendni korrigjimet
13 që i keni bërë deklaratave tuaja të mëparshme duhet të thoni
14 me zë për procesverbal që deklarata, bashkë me korrigjimet e
15 fundit që i keni bërë, pasqyron saktësisht dëshminë tuaj.

16 Flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se
17 të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë që t'ju ndjekin dhe
18 përkthyesit.

19 Nëse unë ju them të mos flisni më, ju lutem, mos flisni
20 më dhe gjithashtu mos flisni më nëse unë ngre dorën. Se kjo do
21 të thotë që unë duhet të jap një udhëzim.

22 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
23 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
24 jashtë sallës së gjyqit. Nëse dikush jashtë Gjykatës ju bën
25 pyetje për dëshminë, na e thoni.

1 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na vini në
2 dijeni, duke ngritur dorën dhe do bëjmë organizimin tonë.

3 Tani do të fillojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë, që
4 janë ulur në të majtën tuaj. Dëgjojeni me vëmendje.

5 Z. Prokuror, fjala është për ju.

6 Pyetje nga z. Pace:

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

9 PË. Kam një kërkesë për Gjyqtarin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, thuaje.

11 DËSHMITARI: Gjyqtar i nderuar, e kam një dëshirë t'ua
12 prezantoj një rregull të familjes sime. A bën? Ngjarje
13 familjare.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi
15 kundërshtim, por të mbarojë njëherë Prokuroria me pyetjet dhe
16 pasi të përfundojë Prokurori mund ta bëni deklaratën tuaj.

17 Doni të veprojmë kështu?

18 DËSHMITARI: Okej. Bën.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. PACE: [Përkthim]

21 PY. Dëshmitar, ne jemi takuar dhe më përpara. Po unë do
22 prezantohem sidoqoftë për procesverbal. Unë quhem James Pace
23 dhe jam unë prokurori që do ju bëj pyetjet sot për
24 Prokurorinë.

25 Siç ta shpjegove edhe gjatë seancës përgatitore javën e

1 kaluar, unë nuk do të bëj pyetje për çdo aspekt të mundshëm
2 sepse ekziston dhe mundësia që të pranojmë disa nga deklaratat
3 që ke dhënë më përpara si provë gjyqësore. Sidoqoftë që ta
4 bëjmë këtë, duhet ta ndjellim disa hapa proceduralë. Dhe do
5 t'i ndjekim këto hapa, por fillimisht do të flasim për
6 identitetin tuaj.

7 Pyetja ime e parë është kjo: Cili është emri dhe mbiemri
8 juaj?

9 PË. Unë jam Demush Krasniqi.

10 PY. Cila është datëlindja juaj?

11 PË. 22 korrik 1956.

12 PY. Baba si e ka emrin?

13 PË. Bajram.

14 PY. Çfarë shtetësie keni?

15 PË. Shqiptare.

16 PY. Në cilin fshat a qytet keni lindur?

17 PË. Kam lindur në fshatin Vllashki, Drenovc, komuna e
18 Malishevës.

19 PY. Çfarë shkolle keni kryer?

20 PË. Kam të kryer shkollën e mesme, teknik i komunikacionit.

21 PY. A punoni aktualisht?

22 PË. Jo, tani jam në pension.

23 PY. Po më përpara se të dilnit në pension çfarë keni bërë?

24 Çfarë pune keni pas?

25 PË. Kam punu në administratën komunale të Malishevës.

1 PY. Po më përpara a keni qenë ndonjëherë vozitës taksie?

2 PË. Po.

3 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të nxjerrim disa materiale në
4 ekran dhe materialet janë publike. Do të fillojmë fillimisht
5 me materialin që mban numrin 051757-051760 dhe përkthimi në
6 gjuhën angleze që përfundon me -ET. Ju lutem faqen e parë të
7 të dyja versioneve.

8 PY. Dëshmitar, a i sheh ato dokumentet që ke përpara në të
9 majtë në shqip dhe në të djathtë është anglishtja, i shihni?

10 PË. Po, i shoh.

11 PY. Siç mund ta shihni, këto dokumente kanë të bëjnë me
12 intervistën që i keni dhënë Prokurorisë Speciale të Kosovës në
13 prill të 2016-s. Të kujtohet ajo intervistë me Specialen e
14 Kosovës?

15 PË. Po, më kujtohet.

16 PY. Tek shqipja që është në të majtë të ekranit ka një
17 nënshkrim poshtë emrit tuaj. A nënshkrimi juaj ai?

18 PË. Po, nënshkrimi im është.

19 Z. PACE: [Përkthim] I lutem Sekretares të shkojmë tek
20 faqja tjetër në të dy dokumentet.

21 PY. Dëshmitar, kjo është faqja e dytë e të njëjtit material,
22 shqipja dhe anglishtja, përkatësisht. Këtu shohim prapë dy
23 nënshkrime tek shqipja. Këto nënshkrimet që shohim këtu a janë
24 tuajat?

25 PË. Po, të dyjat.

1 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit të dy
2 dokumenteve. Ju lutem tek faqja që mban numrin 05670.
3 PY. Dhe në këtë rast, Dëshmitar, janë dy dokumente shqipja
4 dhe anglishtja. Tek shqipja poshtë shohim emrin tuaj dhe
5 nënshkrimin tuaj. A është nënshkrimi juaj ai poshtë emrit?

6 PË. Po, nënshkrimi im është.

7 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua të nxjerrim në ekran 070966-
8 TR-AT Pjesa 1 *Revised* RED dhe versionin në anglisht që
9 përfundon me ET. Të dyja materialet, ju lutem, në faqen e
10 parë.

11 PY. Dëshmitar, a i sheh dy dokumente të tjera në ekranin tuaj
12 në shqip dhe në anglisht?

13 PË. Po, i shof.

14 PY. Dokumenti është një intervistë me Prokurorinë këtu në
15 dhjetor të 2019. A e mban mend të jesh takuar me Prokurorinë
16 rreth kësaj periudhe kohore?

17 PË. Po, e mbaj mend.

18 PY. Ky dokument është ndarë në tri pjesë, është i ndarë në
19 tri pjesë.

20 Z. PACE: [Përkthim] Dhe tani mund ta hiqni ju lutem nga
21 ekрани.

22 PY. Dëshmitar, a e mban mend që javën e kaluar të dhamë
23 mundësinë ta shikoje dhe një herë tekstin që t'i bëje disa
24 sqarime deklaratave që i kishe dhënë më përpara?

25 PË. Po.

1 PY. A e mban mend që t'i bëre disa sqarime, disa korrigjime?

2 PË. Po, e mbaj mend.

3 PY. A të kujtohet që këto sqarime dhe korrigjimet ne i hodhëm
4 në një shënim dhe kur përfunduam ta lexuam atë shënimin?

5 PË. E kuptoj.

6 PY. Tani, duke marrë parasysh dhe ato ndryshimet që hodhëm
7 tek ai shënimi, përmbajtja e deklaratës që i ke dhënë
8 Speciales së Kosovës dhe Prokurorisë që i ke dhënë këtu, a
9 është tashmë i saktë dhe i vërtetë me aq sa besoni dhe mendoni
10 ju?

11 PË. Po, deklarata është e njëjtë që e kam dhënë edhe i
12 qëndroj mbrapa.

13 PY. Duke marrë parasysh korrigjimet që hodhëm tek ai shënimi,
14 deklarata që ke dhënë për Specialen e Kosovës dhe që ke dhënë
15 për Prokurorinë këtu, a pasqyron saktësisht atë që do të
16 thoshit ende sot nëse do t'ju bënin pyetje për të njëjta
17 ngjarje?

18 PË. Po, besoj e njëjta do të jetë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e deklaratave të
20 mëparshme dhe të provave materiale shoqëruese. Numrat përkatës
21 të këtyre dokumenteve i kemi përcjellë në datën 19 shtator
22 2024 mes një poste elektronike dhe në Shtojcën 1 të Shënimit
23 Përgatitor numër 1 si dhe kërkojmë pranimin e Shënimit
24 Përgatitor numër 1 përkatësisht me numër 122855-122859.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

1 kundërshtime?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Përveç kundërshtimeve që kemi bërë
3 më përpara në përgjigjen tonë sipas rregullës 154, ne nuk kemi
4 asnjë kundërshtim të mëtutjeshëm.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të tjerët nuk
6 kanë gjë? Në rregull.

7 Atëherë dokument 051757-051760 RED2 në anglisht dhe në
8 shqip pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
10 numrin e provës P01666. Ju lutem të më thoni çfarë klasifikimi
11 do të ketë.

12 Z. PACE: [Përkthim] Si deklaratat, shënimi përgatitor dhe
13 provat materiale shoqëruese do të kenë klasifikimin publik.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
15 Të gjitha dokumentet do të kenë klasifikimin publik.

16 Dokumenti i radhës me numër 070966-TR-ET Pjesa 1 *Revised*
17 RED, të tria pjesët përkatëse pranohen.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesa 1 do të marri
19 numrin e provës P01667.1, Pjesa 2 do të marri numrin P01667.2,
20 Pjesa 3 do të marri numrin e provës P01667.3.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shënimi
22 Përgatitor me numër 122855-122859 pranohet bashkë me provat
23 materiale shoqëruese.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimi përgatitor do
25 të marrë numrin e provës P01668.

1 Dhe prova materiale shoqëruese të renditura në
2 poshtëshënimin 30 të vendimit sipas rregullës 154 me numër
3 F02585, me ERN për ndryshe 070964 deri në 07965, do të marrë
4 numrin e provës P01669.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 Mund të vazhdoni, z. Pace.

7 Z. PACE: [Përkthim] Gjykatës, më 19 shtator ne kemi
8 dorëzuar një përmbledhje për këtë dëshmitar në bazë të
9 rregullës 154. Nuk kemi marrë asnjë kundërshtim. Dhe me lejen
10 tuaj do të doja ta lexoja me zë për procesverbal.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund ta
12 lexoni.

13 Z. PACE: [Përkthim] Është një përmbledhje e deklaratës
14 sipas rregullës 154 për Dëshmitarin 03885. Dëshmitari 03885 u
15 kyç në njësitin Lumi në Balincë, Malishevë, rreth majit të
16 1998-s dhe më pas shërbeu si anëtar i policisë ushtarake në
17 Brigadën 122, përfshirë dhe në zonën e Dragobilit.

18 Dëshmitari 03885 ka qenë në Dragobil me Fehmi Kryeziun
19 dhe Skënder Hotin kur një veturë me shenjat e UÇK-së mbërriti
20 me dy ushtarë që u prezantuan si pjesëtarë të Shtabit të
21 Përgjithshëm të UÇK-së dhe i kërkuan Dëshmitarit 03885 dhe të
22 tjerëve të shkonin dhe të thërrisnin dy persona që të merrnin
23 pjesë në një mbledhje me OSBE-në.

24 Dëshmitari 03885 dhe të tjerët morën Jakup Kastratin dhe
25 Cen Deskun nga një takim dhe i shoqëruan tek vetura. Kastrati

1 dhe Desku hynë në veturë. Një veturë tjetër më pas u shfaq dhe
2 të dyja veturat u larguan së bashku.

3 Dëshmitari 03885 ka qenë i pranishëm kur Kastrati, Desku
4 dhe të tjerët u liruan rreth një muaj pasi i kishin marrë prej
5 Dragobilit.

6 Dëshmitari 03885 po ashtu jep informata sa i takon rolit
7 të tij dhe të tjerëve në UÇK, si dhe sa i takon strukturës,
8 veprimtarive, kompetencave, zonave të përgjegjësisë dhe vijave
9 të raportimit të njësive të UÇK-së përfshirë njësitin Lumi,
10 Brigadën 121 dhe 122, si dhe njësitë e policisë ushtarake të
11 UÇK-së.

12 Tani mund të kalojmë në seancë të hapur. Dhe dokumentet
13 që do të shfaqim tani mund të jenë dokumentet publike. Le të
14 fillojmë me dokumentin U017-3195-U017-3213 përbri anglishtes
15 me të njëjtën numër ERN. Faqet e para për të dy dokumentet.
16 PY. Dëshmitar, a shihni dy dokumente në ekran? Në të majtë
17 është shqipja dhe në të djathtë është anglishtja.

18 PË. Po, i shof.

19 PY. Këtë dokumentin në shqip a e kishe parë ti ndonjëherë më
20 përpara sesa ta tregoja unë javën e kaluar?

21 PË. Jo.

22 PY. Tek faqja përpara shohim shenjën "Lista e propozimeve të
23 PU-së", dhe ka disa emra këtu.

24 Z. PACE: [Përkthim] Tani shkojmë tek faqja tjetër tek të
25 dy materialet që mban numrin 0173195.

1 PY. Dëshmitar, në këtë faqe tek numri 2 shohim emrin tuaj. Në
2 shqip ta zmadhojmë pak, e zmadhojmë pak pikën 2, shohim dy
3 germa, ZK, janë në mbiemrin tuaj, në shqip çdo të thotë kjo
4 ZK-ja?

5 PË. Zëvendëskomandant i policies ushtarake në Brigadën 122.

6 PY. A e keni pas këtë pozitë në 1998 dhe 1999?

7 PË. Po, e kam pas.

8 PY. Në të njëjtën faqe shohim që tek numri 1 është Sejdi
9 Paqarizi edhe është vënë titulli komandant këtu. A ka qenë
10 vërtet Sejdi Paqarizi komandanti i Dragobilit?

11 PË. Po, Sejdi Paqarizi ka qenë komandant.

12 PY. Që të jemi të qartë, ka qenë komandant i njësisë së
13 policisë ushtarake brenda Brigadës 122?

14 PË. Po.

15 PY. Të njëjtën faqe tek numri 3 shohim emrin Tahir Ulluri. Po
16 ai ka qenë anëtar i njësisë së policisë ushtarake në Brigadën
17 122?

18 PË. Po, më duket që nuk ka qenë. Nuk ka qenë.

19 PY. E njihni ju Tahir Ullurin?

20 PË. E kam takuar gjatë luftës.

21 PY. Gjatë luftës a e dije se në cilën brigadë a njësi ishte?

22 PË. Po, në Brigadën 122.

23 PY. Që ta sqarojmë, ju kujtohet që ka qenë në Brigadën 122,
24 por nuk ju kujtohet a ka qenë me policinë ushtarake, kështu?

25 PË. Detalisht s'po më kujtohet për momentin.

1 PY. Po tek numri 6 emrin, këtë personin me emrin Avni

2 Krasniqi, a e njihni?

3 PË. Avni Krasniqi? Për momentin nuk po më kujtohet.

4 PY. Po Beqir Bashotën, e njihni?

5 PË. Beqir Bashotën? Beqir Bashotën e njoh.

6 PY. Mesa dini ju në 1998, 1999 a ka qenë anëtar i UÇK-së?

7 PË. Po.

8 PY. A ka qenë në Brigadën 122?

9 PË. Po, në Brigadën 122.

10 Z. PACE: [Përkthim] Tani dua të shohim faqen që përfundon
11 me 3198 në të dyja versionet.

12 PY. Dëshmitar, po prapë këtu kemi dhe shqipen dhe anglishten.

13 Tek numri 2 shohim emrin tuaj. Dhe përbri emrit tuaj thuhet që

14 "posedon leje dhe uniformë". Në deklaratën për Prokurorinë

15 këtu ti ke thënë që kur u kyçe në policinë ushtarake të dhanë

16 një mantel të zezë me një embleme. Unë pyetjen e kam këtu, po

17 autorizim a të kanë dhënë ty kur u kyçe në UÇK?

18 PË. S'po e kuptoj. Çfarë autorizimi?

19 PY. Leje, a të kanë dhënë ndonjë lloj leje, ndonjë kartelë --

20 PË. Po.

21 PY. -- që tregonte se ishe anëtar i UÇK-së në 1998, 1999?

22 PË. Po. Leje po.

23 Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër tek të dy

24 dokumentet, përfundon me 3199.

25 PY. Dëshmitar, kartela që keni marrë ju kur keni qenë në UÇK

1 a ngjante me këtë që po shohim tani në ekran, a ngjasonte me
2 këtë?

3 PË. Po, i ngjante.

4 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër 3200, ju
5 lutem.

6 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet nëse kartela që të kanë dhënë
7 kur ishe në UÇK nga mbrapa ishte kështu si kjo që shohim në
8 ekran?

9 PË. Po, kështu ishte.

10 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
11 pranimin e dokumenteve dhe mund të klasifikohen si publikë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
13 kundërshtime?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Ne kundërshtojmë. Ky dëshmitar sapo
16 tha që nuk e ka parë asnjëherë këto dokumentet më përpara.
17 Prokuroria mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit për njësinë e tij,
18 çfarë kishin, diçka që e kanë bërë dhe më përpara, se kjo
19 është e pranuar, por nuk mund të kërkohet që të pranohet
20 dokumenti për vërtetësinë e përmbajtjes.

21 Ju lutem të paktën t'i jepni një numër provizor. Dhe të
22 flas për këtë dokument dëshmitari përkatës që vërtetë e ka
23 parë këtë dokument gjatë luftës. Ne nuk gjykojmë që ky është
24 dëshmitari i duhur për ta bërë këtë. Ky është kundërshtimi
25 ynë.

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Dëshmitari tha që s'e ka
2 parë ndonjëherë më përpara këtë dokument.

3 Z. PACE: [Përkthim] A duhet të përgjigjem?

4 Të nderuar Gjykatës, gjatë këtij gjykimi ne kemi pranuar
5 dhe më përpara dokumente të ngjashme edhe pse dëshmitari nuk
6 ka qenë në gjendje, nuk e ka parë një dokument më përpara. Ne
7 kemi pasur dhe dëshmitarë të tjerë që kanë folur për
8 përmbajtjen e disa materialeve dhe në këtë rast ai ka folur
9 dhe për emrin e tij, detajet e tjera relevante të cilat sipas
10 nesh e përmbushin kriteret për pranueshmëri në këtë fazë.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti do
13 të pranohet, numri i dokumentit U017-3195-U017-3213. Dhe
14 përmbush standardin *prima facie* për pranimin e dokumentit
15 sipas rregullës 138. Është relevant, autentik, ka vlerë
16 provuese. Fakti që dëshmitari nuk e ka parë më përpara këtë
17 dokument nuk është relevant në këtë fazë për pranimin e tij.
18 Dëshmitari ka evidentuar të gjitha faqet ku përmendej emri i
19 tij dhe ka folur për personat e tjera që njihte, kështu që
20 dokumenti do të pranohet.

21 Z. Pace, vazhdoni.

22 Më falni. Para se të vazhdoni do të duhet t'i japim
23 numrin përkatës.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po. Do t'i japim numrin
25 P01670 dhe do të jetë publik.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

2 Vazhdoni.

3 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Do i kërkoja Sekretares
4 të paraqesë në ekran tani dokumentin SITF00439438 deri në
5 00439030 përbri përkthimit në anglisht që mban të njëjtin
6 numër ERN me -ET në fund. Ju lutem paraqisni faqen e parë të
7 të dyja dokumenteve.

8 PY. Dëshmitar, në ekran keni një dokument tjetër, përsëri në
9 të majtë është versioni në shqip dhe në të djathtë është
10 dokumenti në anglisht. A e ke parë këtë dokument përpara sesa
11 ta tregoja përpara një jave unë ty?

12 PË. Jo, nuk e kam pa asnjëherë.

13 Z. PACE: [Përkthim] Tani qëndrojmë tek e njëjta faqe në
14 shqip, ndërkohë në versionin në anglisht do të kërkoja të
15 kalonim tek faqja tjetër. Tek fleta në shqip do ju kërkoja që
16 ta zmadhonit në fund në të majtë.

17 PY. Dëshmitar, në versionin në shqip që keni në ekran, mund
18 të shohim emrin tuaj tek numri 1 në fund të faqes tek ajo
19 pjesa ku shkruhet "Vërejtje për shkak të mungesave".

20 Dhe përkrah emrit tuaj në shqip shohim që ka edhe një
21 nënshkrim, Dëshmitar. A është nënshkrimi juaj ky?

22 PË. Po, nënshkrimi im është.

23 PY. Sikurse e përmenda, emri juaj shfaqet sipër këtij
24 titullit "Vërejtje për shkak të mungesave". A ju kujtohet të
25 keni marrë ndonjë vërejtje në 1998, Dëshmitar, për sa i takon

1 mungesave që keni bërë në 1998 ose 1999?

2 PË. Unë e kisha familjen në male të Turjakës. E kisha nënën,
3 gruan dhe gjashtë fëmijë në male. E ne nganjëherë u detyrojsha
4 të shkoj t'i vizitoj a kanë ushqim edhe si po jetojnë aty. Po
5 nganjëherë u vonojsha për t'u kthyer te shokët e me siguri ka
6 qenë kjo vërejtje e imja. Ishna ma i vjetri në njësit edhe për
7 me kanë të ndërgjegjshëm edhe të tjerët t'i respektojnë
8 rregullat më jepshin mu vërejtje si Demush Laci ta merrni
9 vërejtje që a vonu, nuk ka ardh në kohë.

10 PY. Sapo përmendët, sa thatë Demush Laci --

11 PË. A më fal, Demush Krasniqi.

12 PY. -- sapo thatë Demush Laci. A njifeni kështu, domethënë, ë
13 vend që të njiheni si Demush Krasniqi në 1999 të kanë njohur
14 si Demush Laci, në 1998, 1999?

15 PË. Po lagja ime është Lac. Edhe në fshatin tim kanë qenë tre
16 Demusha. Një ishte gjyqtar. Një ishte arsimtar. E për dallim
17 nga ata shokët ma lanë. Se në familjen time kemi pas shumë
18 ngjarje të rëndësishme. Stërgjyshi im Asllan Laci, Haxhi Laci
19 u thirrshin nga lagja e për këtë edhe mu më thirrshin shokët e
20 mi.

21 PY. Dëshmitar, këtë kritikën ose vërejtjen që ua kanë bërë, a
22 ju kujtohet se këtë vërejtjen që ua kanë bërë kur ua kanë bërë
23 në 1998 apo në 1999?

24 PË. Jo, s'më kujtohet.

25 PY. Këtu poshtë shikojmë emrin Burim Foniqi dhe Ekrem Gashi,

1 a kanë qenë pjesë e Brigadës 122 këta dy persona, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që Qeverisja e Përkohshme e
4 Kosovës është krijuar diku nga marsi apo prilli i 1999?

5 PË. Besa s'më kujtohet koha, data, po e di që është kriju
6 Qeveria e Përkohshme.

7 PY. A ju kujtohet se kur u krijua kjo qeveri është krijuar
8 gjithashtu edhe një ministri e rendit publik, ju kujtohet kjo?

9 PË. Po.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me gjithë
11 respektin kjo është pyetje udhëzuese. Nuk është se e kontestoj
12 në veçanti, po duhet ta bëjë ndryshe pyetjen, pra, duhet të
13 bëjë një pyetje të hapur.

14 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e kuptoj pse
15 duhet të kontestohet.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
17 vazhdoni.

18 Rrëzohet kundërshtimi.

19 Z. PACE: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, po e përsëris edhe një herë pyetjen. A ju
21 kujtohet që në kohën kur është krijuar Qeveria e Përkohshme e
22 Kosovës është krijuar gjithashtu edhe një ministri e rendit
23 publik pak a shumë rreth asaj kohe?

24 PË. Po, më kujtohet është kriju.

25 Z. PACE: [Përkthim] Vazhdojmë të qëndrojmë në njëjtën

1 faqe në shqip, ndërkohë që në anglisht dua që të kaloj tek
2 faqja e parë. Do i kërkoja Sekretares që të zmadhojë pjesën e
3 sipërme, kokën e dokumentit si në shqip dhe në anglisht.
4 Faleminderit.
5 PY. Dëshmitar, sikurse mund ta lexojmë titulli i kësaj faqeje
6 thotë "lista e policëve të rendit publik". Dëshmitar, a keni
7 njohuri në qoftë se ndonjë anëtar i policisë ushtarake të UÇK-
8 së është transferuar tek Ministria e Rendit Publik në ndonjë
9 kohë?
10 PË. Nuk më kujtohet.

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
12 pranohet ky dokument si provë, më konkretisht bëhet fjalë për
13 faqen SITF00439028. Është dokument prej një faqe në shqip.
14 Ndërkohë që në anglisht vazhdohet më tej me përkthimin dhe
15 zgajt dy faqe dokumenti.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
17 kundërshtime?

18 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne
19 kundërshtojmë sepse dëshmitari thotë që nuk e ka parë
20 asnjëherë më përpara këtë dokument. Pra, është absolutisht
21 logjike ky si argument tani sepse ai thotë që thjesht njëh
22 nënshkrimin e vet por ndërkohë do të duhet që të jap shpjegime
23 të tjera sesi ka përfunduar nënshkrimi aty.

24 Pra, ai tha që "Nuk e kam parë asnjëherë këtë dokument",
25 nuk tha që "Nuk më kujtohet" apo ndonjë gjë të ngjashme. Por

1 thjesht tha që "Nuk e kam parë këtë dokument më përpara". Nuk
2 kam asgjë në kundërshtim me atë çfarë tha dëshmitari, por
3 duhen të dhëna të tjera sa i takon këtij dokumenti.

4 Dëshmitari sigurisht që mund të japë pozicionin e vet por
5 Prokuroria mund dhe duhet të kërkojë që dëshmitari të nxjerrë
6 informacione të tjera për të identifikuar se nga ku e ka
7 origjinën apo nga ku ka ardhur ky dokument.

8 Po ashtu ka dhe shumë dëshmi të tjera potenciale në këtë
9 dokument. Dhe duhet vendosur nëse ky mund të pranohet si provë
10 e plotë ose nëse do të duhet t'i kthehemi përsëri më pas për
11 ta shqyrtuar më tej. Ky është rreziku i bërjes së kësaj gjëje
12 në këtë mënyrë.

13 Kështu që procesi për identifikim mund të bëhet më herët
14 dhe pastaj të vendoset më tej në qoftë se do pranohet apo jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SITF00439028
16 deri në 00439030 pranohet si provë gjyqësore pasi e përmbushë
17 standardin minimal sipas rregullës 138.

18 Z. PACE: [Përkthim] Për ta sqaruar, të nderuar Gjykatës.
19 Ne kërkojmë që të pranohet në provë gjyqësore faqja që ju
20 tregua dëshmitarit, që mbulon 028.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm 028?

22 Z. PACE: [Përkthim] Po. Dhe në anglisht është dy faqe.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Atëhere do pranojmë vetëm faqen 028.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

Dëshmitari: Demush Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 21

1 SITF00439028 për versionin në shqip dhe SITF00439028 deri në
2 SITF00439029, që janë dy faqet e tjera të përkthyer në
3 anglisht do të marrin numrin e provës P01671. A mund të
4 konfirmoni klasifikimin?

5 Z. PACE: [Përkthim] Do jetë klasifikim publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje
8 të tjera për këtë dëshmitar. Por sikurse më udhëzuat ju, do
9 t'i kërkoj dëshmitarit që të thotë çfarë dëshironte të
10 thoshte.

11 PY. Dëshmitar, nuk kam pyetje të tjera për ju. Në fillim të
12 seancës thatë që donit të thonit diçka për Trupin Gjykses.

13 Përpara sesa të vazhdoni të tregoni çfarë doni të thoni,
14 a na thoni pak se për çfarë doni të flisni? Dua t'ju kujtoj
15 gjithashtu që jemi në seancë të hapur, që ta keni parasysh.
16 PË. Momentin që kam marrë ftesën për të ardhur këtu për të
17 dëshmuar si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ish-
18 ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kam pasur shumë
19 mysafirë, më kanë përcjellë shokë, veteranë. Dhe këtë dojsa
20 ta thoshja. E në mesin e tyre kisha dhe të fshatrave përreth.
21 Edhe porosia e atyne ishte që unë personalisht t'i përshëndes
22 krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, presidentin Hashim
23 Thaçi, kryeparlamentarin Jakup Krasniqi, Kadri Veselin dhe
24 deputetin e Kosovës Rexhep Selimin. Ma dhanë këtë porosi
25 miqtë, shokët që unë këtë ta përcjelli edhe s'e di a munda ta

Dëshmitari: Demush Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 22

1 përcjelli ashtu si më patën porositur.

2 Kjo ishte.

3 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni se kush janë këta personat
4 ose këta miqtë që të thanë që të jepje këtë mesazh në Gjykatë?
5 A mund të na thoni sesi quhen, kush janë këta persona?

6 PË. Ishin fshatarë të gjitha fshatrave përreth. Kur ndëgjuan
7 që kam me ardhun unë këtu, erdhën të më përcjellin dhe të më
8 urojnë që mundësisht t'i përshëndes këta burra këtu që
9 qëndrojnë.

10 PY. Në rregull. A ju kujtohen emrat e këtyre fshatarëve nga
11 fshatrat përreth këtyre miqve të tu, shokëve të tu nga
12 fshatrat përreth, të kujtohen?

13 PË. Po disa më kujtohen, disa jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A po pyesni
15 për emrat e personave apo emrat e fshatrave? Se mënyra se si e
16 bëtë pyetjen --

17 DËSHMITARI: Jo, jo të fshatrave, fshatarët.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] -- duket
19 sikur po pyesni për fshatrat.

20 Z. PACE: [Përkthim]

21 PY. Jo, për emrat e personave, të fshatarëve që ju thanë që
22 ta jepnit këtë mesazhin. Na thuaj dhe një herë si quhen këta,
23 si quhen, cilët janë?

24 PË. Ishin shokë të mi, ishin miq të mi.

25 PY. Dëshmitar, ndonjë prej këtyre shokëve të tu a të udhëzoi

1 apo të tha ty se çfarë duhet të thoje dhe çfarë nuk duhet të
2 thoje në dëshminë tënde përpara Trupit Gjykues?

3 PË. Jo, jo, jo. Kjo ishte --

4 PY. Për të qenë të qartë --

5 PY. Kjo ishte dëshira ime që ta përcjelli këtë mesazh këtu.

6 PY. E kuptoj. Një sqarim sa i takon kësaj çështjeje. Kur u
7 ftuat për të dhënë dëshmi, pra, dua të di juve e keni fjalën
8 për këto përpara pak muajsh kur ju informuan se do vinit për
9 të dhënë dëshmi këtu, atëherë të kanë kontaktuar këta personat
10 ty, këta fshatarët?

11 PË. Jo, jo, ditën e fundit që kam pas për t'u nisur knejna.
12 Një ditë para se të nisem këtu që të vij.

13 PY. Ishe ti personi që i ke thënë këtyre shokëve të tu që ti
14 do vije për të dhënë dëshmi apo e kanë mësuar ndryshe ata
15 faktin që do vije për të dhënë dëshmi?

16 PË. Jo, ata janë informu, se unë e kam bërë publike që do të
17 vij këtu.

18 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

19 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera, të nderuar
20 Gjykatës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
22 [Përkthim] Pyetjet nga Mbrojtja e z. Thaçi.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës

24 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç:

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. unë quhem Luka Misetiç dhe jam

2 avokati i z. Thaçi. Kam disa pyetje për ty sot paradite.

3 PË. Urdhnoni, i nderuar.

4 PY. Dëshmitar, dëshiroj që të bëjë disa pyetje lidhur me
5 historikun tuaj. Ju jeni kyçur në UÇK në maj të 1998, apo jo,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. I keni thënë ZPS-së se para sesa të kyçeshit kishit
9 dëgjuar nga persona përreth jush se ekzistonte një njësit në
10 zonën aty ku jetonit ju, a është e vërtetë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Kishit dëgjuar që ekzistonte një njësit i UÇK-së në
13 Balincë dhe komandanti atje ishte Enver Hoti. A është e saktë
14 kjo?

15 PË. Po.

16 PY. Kur jeni kyçur për herë të parë keni marrë një uniformë,
17 kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Por është dashur që të keni, që të merrnit armët tuaja
20 personale, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. I keni thënë ZPS-së se në fillim nuk kishte shumë
23 uniforma, kështu që njerëzit zakonisht vishnin çfarëdolloj
24 uniforme që t'ju binte në dorë, a është e saktë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Ky njësiti ku ju u kyçët në Balincë në maj të 1998-s,
2 ishte pjesë e një njësiti më të gjerë që njihej me emrin
3 njësiti Lumi. A është e saktë kjo?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. Në atë kohë ju kur jeni kyç jeni kyç si ushtar i thjesht,
6 apo jo, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Ju nuk jeni stërvitur në nivel profesional kur jeni kyçur
9 në UÇK, kështu?

10 PË. Jo.

11 PY. Çfarëdolloj stërvitje që keni marrë ka qenë stërvitje që
12 ushtarët bënë mes veti, a është e saktë kjo?

13 PË. E saktë.

14 PY. Përpara kësaj i vetmi trajnim apo stërvitje ushtarake ka
15 qenë shërbimi ushtarak i detyrueshëm në armatën jugosllave, a
16 është e saktë kjo?

17 PË. Po, po.

18 PY. Ky njësiti në Balincë ka qenë pjesë e një grupi më të
19 madh në zonën e Malishevës i drejtuar nga Isni Kilaj, a është
20 e saktë kjo?

21 PË. Po.

22 PY. Ju keni qenë pjesë e pikës ose punktut të njësitetit Lumi
23 në Balincë, kështu Dëshmitar?

24 PË. Po, po.

25 PY. Komandanti i njësitetit tuaj ka qenë Enver Hoti, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Isni Kilaj, pra, komanda e Isni Kilajt në njësitin Lumi e
3 ka pas shtabin në Malishevë, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Përpara një jave gjatë seancës përgatitore dhe sipas

6 Shënimit Përgatitor që ka numrin e provës P01668, në

7 paragrafin 11, i keni thënë ZPS-së që njësitin Lumi është

8 krijuar nga Gani Krasniqi që ishte një person me autoritet në

9 zonë, a është e saktë kjo?

10 PË. Po.

11 PY. Ju e njihni personalisht Gani Krasniqin, kështu?

12 PË. Po, e njoh.

13 PY. Për sa kohë e keni njohur atë?

14 PË. E kam njoh prej para lufte.

15 PY. Si e ke njof ti atë përpara lufte?

16 PË. Po ai ishte i burgosur politik edhe jemi afër me fshatra
17 kështu.

18 PY. Çfarë lloj marrëdhënie ke pas me Gani Krasniqin përpara
19 luftës?

20 PË. Jo, kurrfarë.

21 PY. E ke taku ti atë përpara luftës?

22 PË. E kam taku.

23 PY. A keni qenë të dy ju pjesëtarë të LDK-së përpara luftës?

24 PË. Po.

25 PY. Në rregull. Besoj se i keni thënë ZPS-së përpara një jave

Dëshmitari: Demush Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 27

1 se ti ke qenë në LDK përpara luftës, a është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Ti ke qenë drejtuesi i një dege të LDK-së përpara luftës,
4 a është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. E kemi themelur LDK-në në fshatin tonë. Kam qenë anëtar i
6 kryesisë së LDK-së në fshat deri sa ka filluar lufta. Me
7 fillimin e luftës, më nuk kam qenë në LDK.

8 PY. Kur thua kur filloi lufta, e keni fjalën për sulmin në
9 kompleksin e Jasharëve?

10 PË. Po, po.

11 PY. Pra, rreth marsit të 1998 ti nuk ishte më anëtar i LDK-së,
12 e saktë kjo?

13 PË. Që nga marsi i 1998 unë nuk kam qenë më në LDK. Ju kam
14 bashkëngjitur shokëve në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës edhe jam
15 shumë krenar.

16 PY. Po Gani Krasniqi çfarë roli ka pasur në LDK?

17 PË. Nuk di.

18 PY. A e di ti në qoftë se ai ka qenë në LDK?

19 PË. Po në fillim, po.

20 PY. A keni informacion sesi është larguar ai nga LDK-ja?

21 PË. Jo.

22 PY. Ju, ti je shok gjithashtu me Isni Kilajn, a është e saktë
23 kjo?

24 PË. Po.

25 PY. Ju keni shkuar tek shtëpia e tij për t'i uruar shëndet të

- 1 mbarë dhe për t'i uruar më të mirën ndërkohë që ai po
- 2 përgatitej për të ardhur në Hagë --
- 3 PË. Po.
- 4 PY. -- këtë i keni thënë Prokurorit, apo jo?
- 5 PË. Po.
- 6 PY. E konsideron ti shok atë?
- 7 PË. Patjetër. E kam pas shok.
- 8 PY. Në rregull. Ju jeni në dijeni, apo jo, që përveç njësimit
- 9 Lumi në zonën e Malishevës ka pasur edhe një njësit tjetër që
- 10 e ka pas emrin Çeliku, a është e saktë kjo?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Dhe ky njësit, pra, njësiti Çeliku ka qenë njësiti i
- 13 drejtuar nga Fatmir Limaj, a është e saktë kjo?
- 14 PË. Po.
- 15 PY. Në vitin 1998, ju keni qenë në dijeni, apo jo, që ka
- 16 pasur një lloj rivaliteti ose konfrontimi midis njësimit Lumi
- 17 dhe njësimit Çeliku, --
- 18 PË. Jo.
- 19 PY. -- a është e saktë kjo?
- 20 PË. Jo, nuk e di këtë.
- 21 PY. Nuk keni dëgjuar asnjëherë për asnjë lloj tensioni ose
- 22 rivaliteti midis këtyre dy njësiveve?
- 23 PË. Jo, jo.
- 24 PY. Gjatë kohës kur keni qenë ushtar i thjeshtë në punktin në
- 25 Balincë të UÇK-së, ti je vendosur në fshatrat e Balincës,

1 Llazicës dhe një fshat tjetër.

2 PËRKTHYESJA: Përkthyesja nuk e kapi.

3 Z. PACE: [Përkthim]

4 PY. Vermicë.

5 PË. Vermicë.

6 PY. Në tre?

7 Ndërkohë që keni qenë ushtar në njësitin Lumi i keni
8 thënë ZPS-së që nuk ju kujtohet të keni parë ndonjëherë me
9 sytë tuaj një vizitë të ndonjë komandanti epror të UÇK-së.

10 PË. Jo.

11 PY. A është e saktë kjo?

12 PË. Jo.

13 PY. Ju bënë disa pyetje lidhur me kyçjen në policinë
14 ushtarake. I keni thënë ZPS-së që keni marrë një ftesë nga një
15 ushtar tjetër, një bashkëushtar në njësitin Lumi që të
16 kyçeshit në policinë ushtarake, a është e saktë kjo?

17 PË. Po.

18 PY. I keni thënë ZPS-së që personi që të ftoi që të bëheshit
19 pjesë e policisë ushtarake ishte një ushtar i thjeshtë.

20 PË. Po.

21 PY. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Keni thënë që arsyeja që pse ai u ftoi ju ishte që ju
24 konsideroheshit si një ndër personat më të mëdhenj në moshë, a
25 është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. I keni thënë ZPS-së që jeni caktuar në pozicionin e
3 zëvendëskomandantit të policisë ushtarake të skuadrës së
4 Brigadës 122, a është e saktë kjo?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe që jeni kyçur në policinë ushtarake në Dragobil, a
7 është e saktë kjo?

8 PË. Po, po.

9 PY. I keni thënë ZPS-së - dhe për procesverbal kjo jepet në
10 provën gjyqësore P01667.1, faqja 21 - që kur jeni kyçur në
11 policinë ushtarake, pra, në njësinë e policisë ushtarake në
12 Dragobil, kishte borë, domethënë, në tokë kishte borë, a ka
13 qenë kështu? Është se saktë kjo?

14 PË. Po. Vjeshta ishte.

15 PY. Po. Po kishte borë në fakt, kishte ra borë?

16 PË. Po. Një plusk e borës më duket po. Nëse s'gaboj.

17 PY. A do të thotë kjo që ka pasur borë në tokë, në qoftë se
18 ka pas ra borë, a është e saktë që të thuhet që ndoshta ju
19 mund të jeni kyçur diku nga nëntori diku?

20 PË. Nuk e di datën e saktë, veç ishte vjeshta, ashtu ka fund
21 viti. Nuk më kujtohet data, as muaji.

22 PY. Në kohën kur u kyçët i keni thënë ZPS-së që komandanti i
23 policisë ushtarake ishte Jakup Hoti, a është e saktë kjo?

24 PË. Jo, nuk ka qenë Jakup Hoti. Ishte Sejdi Paqarizi.

25 PY. Pra, në momentin kur jeni kyçur në policinë ushtarake

1 komandant ka qenë Sejdi Paqarizi?

2 PË. Sejdi Paqarizi.

3 PY. Këtë po thoni, Dëshmitar, kjo është dëshmia juaj?

4 Ju keni qenë pjesë e këtij njësitit deri kur kanë filluar
5 negociatat në Rambuje, bashkëbisedimet në Rambuje, është e
6 saktë kjo?

7 PË. Po.

8 PY. I keni thënë ZPS-së më tej që jeni kthyer dhe keni
9 shërbyer në policinë ushtarake të UÇK-së në fshatin tuaj, a
10 është e saktë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Sa i takon detyrave tuaja, si anëtar i policisë
13 ushtarake, do kaloj disa prej gjërave që i keni thënë ZPS-së
14 lidhur me këtë temë. I keni thënë ZPS-së që detyrat tuaja si
15 polic ushtarak ose si pjesëtar i policisë ushtarake ishte që
16 të kontrollonit popullatën civile. A është e saktë kjo?

17 PË. Po.

18 PY. Më konkretisht i keni thënë ZPS-së dhe për procesverbal
19 këtë e keni thënë në provën gjyqësore P01667.1, faqja 21 në
20 anglisht.

21 "...detyra jonë ndonjëherë ishte që të shkonim në fshatra
22 të ndryshme në mënyrë që të kontrollonim në qoftë se popullata
23 kishte miell dhe kishte ushqim."

24 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po.

1 PY. I keni thënë ZPS-së se si polic ushtarak detyrat tuaja
2 nuk përfshinin që të ofronit siguri apo organizime të tjera
3 logjistike për komandantë të niveleve më të larta që vizitonin
4 zonën, a është e saktë kjo?

5 PË. Jo.

6 PY. I keni thënë ZPS-së që detyrat tuaja nuk përfshinin
7 arrestimin e personave, a është e saktë kjo?

8 PË. E saktë a. Nuk përfshinin.

9 PY. I keni thënë ZPS-së që këtu përfshihet që ju nuk është se
10 kishit autorizim ose leje që të arrestonit ushtarë të tjerë si
11 puna jote. E keni thënë këtë më konkretisht në faqen 12, të
12 provës P01667.2. A është e saktë kjo?

13 PË. E saktë.

14 PY. I keni thënë ZPS-së që gjatë kohës kur keni qenë pjesë e
15 policisë ushtarake nuk keni marrë asnjëherë urdhra me shkrim,
16 a është e saktë kjo?

17 PË. E saktë është.

18 PY. Ju nuk keni marrë asnjë listë të personave për t'u
19 arrestuar apo të cilët konsideroheshin si të dyshuar --

20 PË. Jo.

21 PY. -- këtë i keni thënë ZPS-së, apo jo, Dëshmitar?

22 PË. Jo, kurrfarë liste s'kemi marrë.

23 PY. I keni thënë ZPS-së në Pjesën 2, në faqen 11 të
24 intervistës tuaj, që ju nuk keni marrë as lista ose nuk keni
25 marrë udhëzime që personat që ishin të përfshirë në LDK të

1 ndaloheshin ose të trajtoheshin si potencialisht persona të
2 dyshuar, a është e saktë kjo?

3 PË. E saktë a.

4 PY. I keni thënë ZPS-së se si anëtar i policisë ushtarake
5 juve nuk ju është ngarkuar asnjëherë detyra që t'i
6 transportonit njerëzit në një vend tjetër në mënyrë të tillë
7 që ata të mund të merreshin në pyetje, a është e saktë kjo?

8 PË. E saktë a.

9 PY. I keni thënë ZPS-së që policia ushtarake ku ke shërbyer
10 ti nuk ka pas asnjë lloj detyre për t'u marrë me
11 kolaboracionistë potencialë ose të mundshëm, a është e saktë
12 kjo?

13 PË. E saktë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, shoh orën, nuk e
15 di në qoftë se doni që të bëjmë një pushim tani apo jo?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do bëjmë
17 një pushim tani.

18 Dëshmitar, do bëjmë një pushim prej dhjetë minutash tani.
19 Ju lutem mos flisni me askënd jashtë sallës së gjyqit për
20 dëshminë përpara Trupit Gjykses. Mund të dilni nga salla tani
21 me Asistenten. Dhjetë minuta pushim, Dëshmitar.

22 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
24 pushim deri në orën 10.10.

25 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

1 --- Seanca rifillon në orën 10.10

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
3 sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë.

6 Dëshmitar, do vazhdojmë tani nga Mbrojtja e Thaçit.

7 Vazhdoni, z. Misetic.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, të flasim pak tani për rastin e Cen Deskut dhe
10 të Kastratit.

11 Në fillim do të doja të fillonim me këtë pikë, gjatë 25
12 viteve të fundit, media, shtypi ka raportuar se ju, z. Hoti
13 dhe Fehmi Kryeziu keni qenë tri personat që keni arrestuar z.
14 Desku dhe Kastrati, kështu?

15 PË. Shumë media kanë raportu për arrestim timin, ne i kemi
16 arrestu. Nuk është e vërtetë. Edhe në deklaratën e parë që e
17 kam dhënë, në intervistën e parë edhe në të dytën ju kam
18 thënë, "Ju lutem, mos e përmendni fjalën 'arrestim' se nuk
19 është e vërtetë".

20 PY. Jo, unë dua të dal këtu --

21 PË. Po.

22 PY. -- ia keni thënë edhe Prokurorisë javën e kaluar në
23 Shënimin Përgatitor numër 1, paragrafi 19, keni thënë se këto
24 pretendimet në media na kanë "njollosur" ne të treve, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Tani të flasim për ato që ju dini vërtetë rreth këtij
2 rasti. Prokurorisë këtu i keni thënë që ju thjesht ishit duke
3 qëndruar në rrugë me dy ushtarë të tjerë të brigadës me
4 Skënder Hotin e me Fehmi Kryeziun kur mbërriti një veturë,
5 kështu ka qenë?

6 PË. Ne kemi qenë -- a mund ta përsëriti? A mund ta përsëriti
7 si ka qenë?

8 PY. Jo, nuk është nevoja. Ta marrim hap pas hapi bashkë që të
9 jemi ne të qartë. Je në rrugë, ti je duke qëndruar në rrugë me
10 Skënder Hotin dhe me Fehmi Kryeziun.

11 PË. Po.

12 PY. Thjesht rastësisht aty mbërrin një veturë, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Mirë. Po prapë thjesht rastësisht ju këtë veturën e
15 njohët dhe sipas jush kjo veturë ishte e Shtabit të
16 Përgjithshëm të UÇK-së, kështu?

17 PË. Po, kishte emblemat UÇK.

18 PY. Po. Por emblemat e UÇK-së nuk shkruajnë "Shtabi i
19 Përgjithshëm", apo jo?

20 PË. Jo, nuk shkruajnë.

21 PY. Tani pyetja e parë që kam unë është kjo: Nëse në veturë
22 ishte një emblemë "UÇK", nga e dije ti që vetura ishte e
23 Shtabit të Përgjithshëm?

24 PË. Po personat që dolën nga vetura ishin dy ushtarë. Edhe
25 neve na panë duke biseduar aty. Ishmja unë, Skënder Hoti dhe

1 Fehmia dhe disa ushtarë. Na thanë, "Kemi ardhur dy shokë t'i
2 marrmi, dy njerëz t'i marrmi këtu janë në këtë shtëpinë e
3 OSBE-së këtu". Ne nuk e kemi ditë për kën është fjala. Nga ne
4 shkoi Fehmiu, ishte ma i ri, trokiti në derë edhe i thirri.
5 Kur dulën ata i pamë kush janë.

6 PY. Ndalo një sekondë këtu. Ndalojmë këtu. Të flasim njëherë
7 për veturën. A pajtoheni me mua që në veturë nuk kishte asnjë
8 mbishkrim "Shtab i Përgjithshëm"?

9 PË. Jo, nuk ka pas.

10 PY. Pra, kur e pe veturën ti nuk e dije që vinte nga Shtabi i
11 Përgjithshëm?

12 PË. Jo.

13 PY. Por këta dy ushtarët që ti nuk e dije kush ishin, nuk e
14 dije kush ishin këta ushtarët, apo jo?

15 PË. Jo, jo.

16 PY. As sot e kësaj dite nuk e di kush janë, apo jo?

17 PË. Jo, nuk i njoh ata.

18 PY. Ushtarët nuk t'u prezantuan me emër, apo jo?

19 PË. Jo, vetëm thanë "Kemi ardh me marrë dy njerëz janë këtu".
20 Ne tu mendu që janë njerëzit e tyre.

21 PY. Po. Po unë dua të kuptoj një gjë. Ata nuk u prezantuan.
22 Erdhën dhe thanë që do marrim dy njerëz, ti nga e di që ishin
23 nga Shtabi i Përgjithshëm?

24 PË. Po, "Erdhëm t'i marrmi për një bisedë që të bisedonin me
25 ta". Nuk e dija çfarë d të bisedonin. Ne menduam që janë

Dëshmitari: Demush Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 37

1 njerëzit e tyre që i kanë prurë këtu dhe po i marrin prapë.

2 PY. Jo, nuk e kisha këtu pyetjen. Unë pyetjen e kam kështu:

3 Nga e dini ju që këta dy ushtarë të thjeshtë ishin nga Shtabi
4 i Përgjithshëm? Nga e dini ju këtë?

5 PË. Po, ne na u prezantun ashtu.

6 PY. Ju i keni thënë Prokurorisë këtu që ata nuk ishin anëtarë
7 të Shtabit të Përgjithshëm, po që ishin thjesht ushtarë të
8 Shtabit të Përgjithshëm. Dhe unë po ju pyes nga e dini ju që
9 nuk ishin ata anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm?

10 PË. Jo, nuk po e kuptoj çka je tuj më thanë.

11 PY. Mirë. Nga e dije ti që nuk ishin, për shembull, ku e dije
12 ti që nuk ishin komandanti i përgjithshëm i UÇK-së ata?

13 Domethënë, unë po përpiqem të them këtë, ku e di ti çfarë
14 pozite kishin ata në UÇK? Prokurorisë i ke thënë ishin ushtarë
15 të thjeshtë. Nga e di ti?

16 Z. PACE: [Përkthim] Më jepni, ju lutem, referencën.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, këtë ia keni thënë Prokurorisë
18 Speciale, ishte gabimi im. E keni thënë në deklaratën e 2016,
19 numri është P01666, faqja 3.

20 PY. Po ua lexoj, këtë ke thënë në 2016:

21 "Ky person na tha nga vetura ku hyri Ceni dhe Jakupi se
22 Ceni dhe Jakupi do të jepnin një deklaratë për takimin me
23 zyrtarët e SHBA-së. Këta persona nuk ishin persona publikë,
24 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, po këta ishin ushtarë të
25 thjeshtë."

1 PË. Kështu e kam thënë.

2 PY. Po. Dhe unë po pyes tani kështu: Nga e di ti që nuk ishin
3 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm ata, por që ishin ushtarë
4 të thjeshtë? Nga e di ti këtë gjë?

5 PË. Po si mbas -- ne aty për aty nuk mujshim të shifshim te
6 ta asgjë përveç uniformës që e kishin si ushtarë të Ushtrisë
7 Çlirimtare.

8 PY. Çfarë shenje dalluese duhet të kishte një anëtar i
9 Shtabit të Përgjithshëm sipas jush? Çfarë tipari ndryshe?

10 PË. Kurrfarë shenje dalluese nuk ka qenë, vetëm prezantimi i
11 tyre.

12 PY. Ata nuk ju pyetën për emrat juve, apo jo?

13 PË. Jo.

14 PY. Domethënë, vijnë disa persona që ju nuk i njihni, as ata
15 nuk ju njohin ju, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Këta dy persona dhe kjo e gjitha ka ndodhur në mënyrë
18 rastësore, thjesht rastisën, thjesht ata rastisën aty kur
19 qëndroje ti në rrugë, apo jo?

20 PË. E tëra ka qenë e rastësishme. As i kemi dit kush a brenda
21 aty, as kush do të dalë kur t'i thirrmi ne. Vetëm kur i kemi
22 pa që dualën Ceni dhe Jakupi.

23 PY. Ti ke thënë që ata në fakt pyetën një nga ju të tre, i
24 kërkuan, pra, ata i kërkuan njërit prej jush, ju të treve, që
25 të shkonte brenda aty tek zyra dhe të thërriste dy persona që

1 ishin tek zyra amerikane, kështu ka qenë?

2 PË. Po, kështu ka qenë.

3 PY. Po e lexoj çfarë i keni thënë Prokurorisë këtu. Kjo ka
4 numrin P01667:

5 "Ata thanë, mu drejtuan mua dhe më thanë: O zotëri, a
6 është e mundur të shkosh të thërrasësh dy persona'? Ne shkua
7 te dera, shkua afër derës dhe Fehmiu, që ishte më i ri se ne,
8 trokiti në derë dhe tha: 'A është e mundshme se po ju
9 kërkojnë këta dy ushtarët?'."

10 PË. Kështu ka qenë.

11 PY. Më pas ke thënë kështu, "Si përfundim z. Desku dhe z.
12 Kastrati dolën nga ajo zyra ku ishin". Kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Ti e njihje personalisht Cen Deskun dhe Jakup Kastratin
15 që nga përpara, kështu?

16 PË. Si arsimtarë i kam njoft të dytë.

17 PY. Po, ishin persona të njohur në zonë, apo jo?

18 PË. Si të gjithë tjerët.

19 PY. Ishin arsimtarë, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe ishin drejtues të degës së LDK-së atje, apo jo?

22 PË. Jo, për drejtues nuk e di. Vetëm si anëtarë të LDK-së.

23 PY. Ti ke thënë që ia shpjegove Cen Deskut dhe Jakup
24 Kastratit se po i kërkonin dy ushtarë për një konsultim, për
25 një bisedë, kështu?

1 PË. Ne as që kemi biseduar me ta aty.

2 PY. Po të lexoj çfarë i keni thënë Prokurorisë - është
3 dokumenti me numër P1667.2, faqja 5, në fillim të rreshtit 23
4 - ke thënë kështu:

5 "Po. Dhe ne ju thamë atyre se 'Po ju thërrasin këta dy
6 ushtarët që shkoni për një bisedim'. Pasi hynë në veturë unë
7 dëgjova që pasi hynë në veturë, unë pash një veturë tjetër që
8 u afrua aty dhe të dyja veturat shkuan drejt Maralit ... në
9 drejtim të Pagarushës."

10 Pra, a j the ti atyre që "Shiko po ju thërrasin dy
11 ushtarë për një bashkëbisedim"?

12 PË. Po, një tash nuk po më kujtohet detalisht po nuk kemi
13 bisedu. Po edhe t'u kisha thënë që "po ju thërrasin qëta dy
14 ushtarët" nuk ka qenë asnjë e keqe, asgjë e mundimshme, se unë
15 i njifsha ata. Edhe ne tu mendu që po shkojnë për ndonjë
16 bisedë kështu normale.

17 PY. Në 2016 te deklarata që ke dhënë për Specialen e Kosovës
18 ke thënë që një prej dy këtyre personave që ishte me veturë të
19 tha që "Ceni edhe Jakupi duhet të vijë të japin një deklaratë
20 për takimin që kanë pasur me zyrtarët e SHBA-së, amerikanë",
21 kështu?

22 PË. Nuk e di për atë deklaratë ashtu, mirëpo ata s'kanë
23 përmend emna as Cenin, as Jakupin, këta dy ushtarët. Vetëm
24 kanë thënë "Dy persona po i kërkojmë këtu janë brenda". Kur
25 kanë dalë ata i kemi pa kush janë.

1 PY. Po të lexoj Prokuroria -- i ke thënë Prokurorisë së
2 Kosovës. Është dokumenti me numër P01666, faqja 3. Ju thatë
3 kështu:

4 "Ky personi na tha nga vetura se Ceni dhe Jakupi duhet të
5 japin një deklaratë për takimin që kanë pasur me zyrtarët
6 amerikanë."

7 Ai personi nga vetura a ta tha këtë?

8 PË. Jo.

9 PY. Domethënë, kjo pjesë e deklaratës është e pasaktë?

10 PË. Jo, jo, nuk ma kanë thënë.

11 PY. Pasi hyjnë në veturë Ceni dhe Jakupi hipën edhe këta dy
12 ushtarët në veturë?

13 PË. Po.

14 PY. A mund të na e përshkruani si dukeshin fizikisht, çfarë
15 pamje fizike kishin këta dy ushtarë?

16 PË. Po pamjen fizike tash, unë atëherë kam qenë 40-vjeçar,
17 ashtu si unë më duket kanë qenë në q'atë moshë. Edhe s'më
18 kujtohen për momentin çfarë moshe kanë qenë atëherë, a kanë
19 qenë ma të rinj a më të vjetër a. S'mund të përcaktohen.

20 PY. Ju thoni, ju keni thënë që në ato momente erdhi dhe një
21 veturë tjetër, kështu?

22 PË. U bashkua dhe një veturë tjetër.

23 PY. Dhe ke thënë që nuk ke njohur asnjë prej personave që
24 ishte në veturën e dytë, kështu?

25 PË. Jo, jo s'i kam njoft.

1 PY. Kur të ka bërë pyetje Prokurori të flisje për veturën ke
2 thënë:

3 " ... ishte një veturë civile, ishte ... Mercedes o Ascona,
4 nuk më kujtohet."

5 Kështu?

6 PË. Kështu ka qenë. Nuk më kujtohet çfarë ka qenë.

7 PY. I keni thënë Prokurorisë së Kosovës në provën materiale
8 P01666, në faqen 4. Ke thënë:

9 "Pas veturës ku ishte Ceni dhe Jakupi po voziste një
10 veturë tjetër për të shkuar në fshatin Dragobil - më falni -
11 në fshatin Dragobil, unë nuk e di a po ndiqte veturën e parë
12 apo thjesht rastisi që të kishte rrugën andej."

13 A të kujtohet?

14 PË. Po, më kujtohet. Dhe nuk e di a kanë qenë bashkë ato dy
15 vetura a kjo e dyta ka qenë veturë tu shku rrugës vetë, në
16 punën e vet. Nuk e di që kanë qenë së bashku.

17 PY. Pra, ju po thoni që nuk e dini nëse vetura e dytë kishte
18 lidhje me Cen Deskun dhe Jakup Kastratin, kështu?

19 PË. Jo, nuk e di.

20 PY. Prokurorisë i keni thënë që nuk e keni parë Hashim Thaçin
21 ditën që Cen Desku dhe Jakup Kastrati hynë në veturë, kështu?

22 PË. Jo, nuk ka qenë. Nuk e kam pa. Edhe s' ishte.

23 PY. Ju ka pyetur Prokuroria në provën P01667.2, faqja 10,
24 pra, ju ka bërë këtë pyetje:

25 "Në ato momente, a e kishit parë ndonjëherë Hashim

1 Thaçin, o të paktën a e njihnit me fytyrë a me pseudonim?"

2 Dhe ju i jeni përgjigjur:

3 "Jo, jo, jo. Vetëm pas luftës e kam mësu."

4 Kështu?

5 PË. Po.

6 PY. I keni thënë Prokurorisë se dy ditë pasi u largua Cen

7 Desku dhe Jakup Kastrati, ty të thanë se ata ishin arrestuar,

8 kështu?

9 PË. U informum, po.

10 PY. Ky informacion ishte në formën e thashethemeve, mes

11 njerëzve?

12 PË. Mes njerëzve.

13 PY. Po më konkretisht a të kujtohet kush të informoi ty se

14 ishin arrestuar ata?

15 PË. Po nuk e di kush po na patën ardh te shtëpia familjarët e

16 tyne.

17 PY. Ju keni qenë dëshmitar për faktin që atyre iu kërkua të

18 dilnin nga ndërtesa e OSBE-së dhe të hynin te vetura --

19 PË. Po.

20 PY. -- dhe këtë ua kërkuan dy persona.

21 Pasi filluan bisedimet brenda këtyre -- pasi filluan këto

22 fjalën brenda dy ditësh pasi ishin arrestuar këta, ti i

23 raportove komandantit tënd Enver Hoti se ti dhe dy anëtarë të

24 njësisë së Enver Hotit kishin qenë aty të pranishëm kur Jakup

25 Kastratin dhe Cen Deskun i kishin futur në një veturë dy

1 ushtarë nga Shtabi i Përgjithshëm?

2 PË. Unë e kam bisedu që i kanë marrë dy persona dhe mbasi

3 kanë dalë i pamë që janë Jakupi edhe Ceni. A për çfarë i kanë

4 marrë nuk di. Nuk dija. S'kisha informacione.

5 PY. Kujt ja ke treguar ti?

6 PË. Po shokëve të mi, shokëve që ishim me ta së bashku.

7 PY. Po Enver Hotit a ia the?

8 PË. Enver Hotit shumë vonë e kam pa se isha me Sejdi

9 Paqarizin tani unë. Me komandantin e policie ma shpesh
10 rrijsha.

11 PY. Domethënë, ja ke treguar Sejdi Paqarizit, kështu?

12 PË. Po, po.

13 PY. Po Isni Kilajt ja the?

14 PË. Po shumë vonë jam pas taku me Isni Kilën. Po edhe ai a
15 kanë informu për këtë punë, për këtë rast.

16 PY. Nga kush?

17 PË. Po nga njerëzit, nga ushtarët, nga civilët. U bisedohke
18 që Ceni dhe Jakupi u morën në pyetje.

19 PY. Po nga e di ti që u informua ai?

20 PË. Po nuk ka pas person që s'e ka pas dit për marrjen e
21 tyne.

22 PY. Po Gani Krasniqi a e ka dit?

23 PË. Nuk e di. Besoj që e ka dit, po nuk e di mbasi s'jam taku
24 me të.

25 PY. Ti vetë nuk ja tregove?

1 PË. Jo.

2 PY. Prokurorisë i ke thënë që ti vetë nuk e ke ditur ku i
3 kanë mbajtur ata të ndaluar?

4 PË. Jo.

5 PY. Po ashtu i ke thënë Prokurorisë se nuk e dinit
6 vendndodhjen e tyre dhe çdo gjë që ke mësuar ti për ndalimin e
7 tyre është diçka që e ke lexuar ose e ke mësuar më vonë,
8 kështu?

9 PË. Kështu ka qenë

10 PY. Sikurse vetë thatë, erdhi të t'takojë familja e Cen
11 Deskut, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Ti i takove personalisht ata?

14 PË. Po.

15 PY. Atyre u the të njëjtën gjë që po na thua ne këtu --

16 PË. Të njëjtën gjë -

17 PY. -- që thjesht ishe --

18 PËRKTHYESJA: Ja, më lini të mbaroj fjalinë, ju lutem.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Pra, domethënë, ti atyre u the të njëjtën gjë që na the
21 ne këtu?

22 PË. Po, të njëjtën gjë u kam thënë edhe atyre.

23 PY. Ti vetë nuk ke parë asnjëherë ndonjë urdhër me shkrim nga
24 Shtabi i Përgjithshëm për arrestimin e Cen Deskut dhe Jakup
25 Kastratit, apo jo?

1 PË. Jo, nuk ka pas.

2 PY. A është e vërtetë që asnjëherë nuk i ke treguar familjes
3 së Cen Deskut një urdhër me shkrim nga Shtabi i Përgjithshëm
4 për arrestimin e tyre?

5 PË. Jo.

6 PY. Ju keni qenë i pranishëm kur janë liruar të dy, Cen Desku
7 dhe Jakup Kastrati, apo jo?

8 PË. Po, kam qenë prezent.

9 PY. Ishte kështu komplet --

10 PË. Nuk më ka ardh asnjë lajm, asnjë zë. S'po dëgjoj.

11 PËRKTHYESJA: A dëgjoni tani, Dëshmitar?

12 DËSHMITARI: Po.

13 Z. MISETIC: [Përkthim]

14 PY. Nuk është se keni pas ndonjë kapacitet, nuk keni qenë në
15 ndonjë cilësi zyrtare, apo jo, kur ka ndodhur kjo, Dëshmitar?

16 PË. Jo, jo.

17 PY. Ta sqarojmë pak këtë çështje. Në seancën përgatitore me
18 ZPS-në përpara një jave në provën P01668, në paragrafin 19, ju
19 thoni si më poshtë, nuk keni qenë prezent në asnjë cilësi
20 zyrtare kur Kastrati dhe Desku janë liruar. Thjesht rastisi që
21 të ishit në Dragobil dhe dëgjove që ata u liruan dhe ti shkove
22 për të parë që ata ishin liruar. A është e saktë kjo,
23 Dëshmitar?

24 PË. Ashtu është. E saktë është.

25 PY. Ju vetë ishit i stacionuar në Dragobil në kohën kur keni

1 qenë me policinë ushtarake, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. ZPS-ja ju ka treguar një video gjatë intervistës, pra,
4 video të lirimit të tyre dhe në sekondën e 36 të videos ZPS-ja
5 ju ka treguar imazhe të ndërtesës në Dragobil pas personave të
6 liruar. A ju kujtohet ta keni parë këtë video, Dëshmitar?

7 T'jua sqarojmë. E kam fjalën për intervistën që i keni
8 dhënë ZPS-së.

9 PË. Po.

10 PY. A ju kujtohet që ju kanë treguar një video gjatë
11 intervistës --

12 PË. Po.

13 PY. -- me Prokurorin?

14 PË. Po, më kujtohet.

15 PY. A ju kujtohet që u bënë pyetje lidhur me një ndërtesë të
16 caktuar në atë video, ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Kjo jepet në intervistën që keni pas me ZPS-në në provën
19 P01667.2, faqja 18, rreshti 22. Pyetja që ju bëhet juve është
20 kjo:

21 "A e njihni ndërtesën që është pas tyre?"

22 Dhe ti përgjigjesh:

23 "Po, kjo është në Dragobil.

24 "PY. A dini gjë tjetër lidhur me këtë ndërtesë? A është
25 përdorë ajo nga UÇK-ja?"

1 Dhe përgjigja që ju jepni është:

2 "Jo."

3 PË. Jo, jo.

4 PY. A është e saktë kjo?

5 PË. Jo, jo.

6 PY. Në rregull. A jeni në dijeni që Jakup Kastrati në vitin
7 2016 në deklaratën që i ka dhënë hetuesve lokalë në Prishtinë
8 ka thënë që ju keni qenë një ndër personat e përfshirë në
9 arrestimin e tij?

10 PË. Tash po e ndëgjoj.

11 PY. Në rregull. Jakup Kastrati thotë që ose i kujtohet që ti
12 i ke thënë atij që ke pas urdhra për të arrestuar atë dhe i ke
13 thënë që duhet që t'i zbatoj ato urdhra, a është e saktë kjo,
14 Dëshmitar?

15 PË. Jo.

16 PY. Gjatë intervistës ZPS-ja ju ka pyetur si më poshtë, "Në
17 kohën kur Cen Desku dhe Jakup Kastrati u morën në veturë, ju
18 nuk e dini se për çfarë arsye janë marrë ata?". A është e
19 saktë kjo?

20 PË. E saktë.

21 PY. Po më pas ju thoni - dhe përsëri këtë e thoni në provën
22 P0167.2, faqja 11, rreshtat 12 deri në 21 - ju thoni si më
23 poshtë:

24 "Më pas e kuptova që ata u morën për t'u marrë në
25 pyetje."

1 Dhe thua që:

2 "Ata janë marrë si njerëz të LDK-së."

3 A është e saktë kjo?

4 PË. Në mesin tonë shumë ka pas njerëz të LDK-së edhe në
5 Ushtrien Çlirimtare të Kosovës. Nuk na ka pengu ajo aspak.

6 PY. Ta marrim hap pas hapi. Ju thoni që nuk na ka pengu ajo,
7 domethënë, nuk ka pas pengesë që të ishe anëtar i LDK-së edhe
8 të kyçeshe gjithashtu në UÇK, a është e saktë kjo?

9 PË. Po, e saktë a.

10 PY. Kur keni dhënë dëshmi më herët, që u larguat nga LDK-ja
11 në mars dhe u kyçët në UÇK, nuk është se kishte ndonjë kërkesë
12 të posaçme që ju duhej që ta linit LDK-në dhe të kyçeshit në
13 UÇK, kështu, Dëshmitar?

14 PË. Jo, nuk kish kërkesa të posaçme.

15 PY. Në rregull. Tani do t'i kthehem pyetjes që ju bëra pak më
16 herët. I keni thënë ZPS-së duke ju referuar z. Desku dhe
17 Kastratit që:

18 "Ata janë marrë si njerëz të LDK-së."

19 Pyetja ime për ju është kjo. Pse e keni thënë këtë,
20 Dëshmitar?

21 PË. Kanë qenë anëtarë të LDK-së, por për që kanë qenë anëtarë
22 të LDK-së nuk janë marrë. Po unë kam mendu që janë marrë si
23 arsimtarë që të bisedohet me ta.

24 PY. Nga e dini ju sesi janë marrë ata?

25 PË. Në momentin që janë marrë q'atë prej momentit që janë

1 marrë që atëherë e di, jo më herët as më vonë.

2 PY. Sa i takon arsyes pse ose motivit të marrjes së tyre nga
3 e dini se pse janë marrë sepse i keni thënë ZPS-së se ata janë
4 marrë si njerëz të LDK-së. Ndërkohë që sot po thua që janë
5 marrë si mësues. Nga e dini ju se cila ka qenë arsyeja ose
6 motivimi për t'i marrë ata nga personat që i kanë marrë
7 sigurisht?

8 PË. Jo, jo, nuk e di këtë punë. Nuk e di pse janë marrë.

9 PY. Në rregull.

10 PË. Edhe pse kanë qenë njerëz të LDK-së, nuk e di arsyen pse
11 janë marrë.

12 PY. A e dini në qoftë se Desku dhe Kastrati kanë pasur ndonjë
13 marrëdhënie armiqësore me Gani Krasniqin në tetor të 1998?

14 PË. Jo, nuk e di këtë.

15 PY. Keni thënë që i keni njohur të dy, Isni Kilajn dhe Gani
16 Krasniqin përpara sesa të kyçeshit në UÇK, a është e saktë
17 kjo?

18 PË. Po.

19 PY. I keni thënë ZPS-së - në Pjesën 1, faqja 14 të
20 intervistës me ZPS-në - që "ai ka qenë një njeri ... me shumë
21 autoritet, me shumë kompetencë", duke ju referuar Gani
22 Krasniqit, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. I keni thënë ZPS-së që e dini që Isni Kilaj dhe Gani
25 Krasniqi ishin në të njëjtin shtab. A është e saktë kjo?

1 PË. Po.

2 PY. Ju të tre që keni qenë të pranishëm ditën kur ata u futën
3 në atë veturë, domethënë, ti, Fehmi Kryeziu dhe Skënder Hoti
4 keni qenë pjesëtarë të njësimit Lumi që drejtohej nga Isni
5 Kilaj dhe Gani Krasniqi, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. A kam të drejtë, a jam i saktë, dhe besoj që këtë e keni
8 thënë dhe sot më herët paradite që Isni Kilaj dhe Gani
9 Krasniqi kanë qenë anëtarë të degës së LDK-së në Malishevë?

10 PË. Po.

11 PY. Është e saktë kjo?

12 PË. Po.

13 PY. Sikurse dëshmuat si sot, po edhe sikurse i keni thënë
14 ZPS-së përpara një jave, ti ke qenë themeluesi i LDK-së në një
15 degë të LDK-së në Llashka Drenoc?

16 PË. Në Vllashki Drenoc kam qenë. Po.

17 PY. Për të qenë të qartë, ti ke qenë themeluesi i LDK-së në
18 Vllashka Drenoc, kështu, Dëshmitar?

19 PË. Po.

20 PY. Si themelues i LDK-së në Vllashka Drenoc a ke qenë në
21 dijeni të një asambleje ose një mbledhje të jashtëzakonshme të
22 LDK-së në Malishevë në vitin 1998?

23 PË. Jo. Nuk di për këtë.

24 PY. Nuk keni qenë në dijeni që brenda komunës së Malishevës
25 në shkurt të 1998 ka pasur një asamble të jashtëzakonshme të

1 LDK-së të mbledhur ku Gani Krasniqi dhe Isni Kilaj kanë qenë
2 pjesëtarë të një përpjekje të LDK-së për ta hequr Ibrahim
3 Rugovën si drejtuesin e LDK-së?

4 PË. Jo. Kët q'tash po e ndëgjoj.

5 PY. A jeni në dijeni që Gani Krasniqi dhe Isni Kilaj janë
6 shkëput nga LDK-ja rreth ose në mars të 1998 pothuajse në të
7 njëjtën kohë kur jeni shkëput dhe juve nga LDK-ja, a jeni në
8 dijeni të kësaj?

9 PË. Nuk më kujtohet koha kur. Nuk më kujtohet.

10 PY. A jeni në dijeni që ata janë larguar nga LDK-ja dikur,
11 domethënë, një kohë të caktuar nga pranvera e 1998, Dëshmitar?

12 PË. Po, po.

13 PY. A jeni në dijeni që Gani Krasniqi dhe Isni Kilaj pasi u
14 larguan nga LDK-ja u përpoqën që të mbyllnin zyrën ose degën e
15 LDK-së në Malishevë?

16 PË. Për këtë nuk e di. Nuk e di.

17 PY. A jeni në dijeni që Gani Krasniqi dhe Isni Kilaj kanë
18 pasur mëri personale me personat që kanë mbetur në degën e
19 LDK-së në Malishevë, përfshirë këtu Cen Deskun dhe Jakup
20 Kastratin?

21 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Avokati nuk ka
22 dhënë bazën e kësaj pyetjeje. Në qoftë se nuk ka bazë nuk
23 duhet të bëhet pyetja.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtohet
25 kundërshtimi i Prokurorit.

1 Mund t'i përgjigjeni pyetjes, Dëshmitar.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Doni t'jua bëj dhe një herë pyetjen apo e mbani mend?

4 PË. Po dhe një herë se s'e kuptoj.

5 PY. A jeni në dijeni që Gani Krasniqi dhe Isni Kilaj kanë
6 pasur një mëri personale lidhur me personat që kanë vazhduar
7 që të mbesin brenda degës së LDK-së në Malishevë, përfshirë
8 këtu dhe Cen Deskun dhe Jakup Kastratin?

9 PË. Jo.

10 PY. A e dini këtë gjë?

11 PË. Jo, jo, jo. S'kanë pas mëri nga askush.

12 PY. A jeni në dijeni që Cen Desku dhe Jakup Kastrati kanë
13 dhënë mbështetjen e tyre politike për Fatmir Limajn si
14 komandant i njësimit Çeliku në atë kohë?

15 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kundërshtojmë
16 nuk ka themel pyetja. Nuk mund të bëhet një pyetje që nuk ka
17 themel.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
19 kundërshtimi.

20 Ju lutem mund të vazhdoni dhe përgjigjuni pyetjes,
21 Dëshmitar.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam edhe referencën e
23 transkriptit.

24 PY. Po jua bëj dhe një herë pyetjen, Dëshmitar. A jeni në
25 dijeni që Cen Desku dhe Jakup Krasniqi kanë dhënë mbështetjen

1 e tyre për Fatmir Limajn si komandant i njësimit Çeliku në atë
2 kohë?

3 PË. Jo, nuk e di këtë.

4 PY. A u kujtohet që Cen Desku dhe Jakup Kastrati mendohej që
5 të jepnin një deklaratë sa i takon takimit të tyre me zyrtarët
6 e Kombeve të Bashkuara në atë kohë? Jua bëra dhe një herë këtë
7 pyetje: A ju tha personi në veturë që ata kishin ardhur për të
8 marrë Cen Deskun dhe Jakup Kastratin për t'i marrë në pyetje
9 sa i takon takimit me zyrtarët e Kombeve të Bashkuara?

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ka një
11 gabim në transkript në faqen 47, rreshti 19 thuhet "Jakup
12 Krasniqi" aty. Po në fakt duhet të jetë "Jakup Kastrati".

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të
14 korigjohet.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Personi në veturë, ushtari që ishte aty në veturë, a të
17 ka thënë ty që ata kishin ardhur për të marrë Cen Deskun dhe
18 Jakup Kastratin për t'i bërë pyetje sa i takon takimit që ata
19 kishin pasur me zyrtarët e Shteteve të Bashkuara?

20 PË. Jo.

21 PY. Arrestimi i Deskut dhe Kastratit brenda rajonit të
22 Malishevës, a njollosoi reputacionin e tyre kjo gjë, domethënë,
23 arrestimi i tyre në atë kohë?

24 PË. Po ai -- s'di ç'të them për atë. Çdo arrestim njolloso
25 personin, po varet qysh e kanë marrë ata.

1 PY. Keni dhënë dëshmi që ka pasur shumë diskutim, është folur
2 shumë lidhur me këtë, përfshirë këtu edhe veten tuaj,
3 domethënë, ka pasur goxha biseda sa i takon ndalimit në
4 momentin kur ata janë arrestuar. Domethënë, a ka qenë kjo
5 pjesë e bisedës pse janë dyshuar si bashkëpunëtorë këta
6 persona?

7 PË. Po nuk muj të di unë çka kanë bisedu njerëzit se në
8 prezencën time nuk kanë fol ata.

9 PY. Dëshmitar, do ju kërkoj të jepni komentet tuaja personale
10 lidhur me këtë. Në qoftë se dikush do thoshte që ti, Skënder
11 Hoti dhe Fehmi Kryeziu, ka qenë personat që kanë arrestuar Cen
12 Deskun dhe Jakup Kastratin me urdhër nga eprorët tuaj në
13 njësitin Lumi, dhe që ju tani po përpiqeni që të mbronni shokët
14 tuaj duke sajuar një histori që kanë qenë dy ushtarë anonimë
15 nga Shtabi i Përgjithshëm që i kanë marrë ata dhe që ti ke
16 qenë i vetmi dëshmitar, si do komentoni një situatë të tillë?
17 Çfarë do thonit ju në këtë skenar?

18 PË. Ma thuaj dhe një herë ma shkurt? Se shumë gjatë ishte.

19 PY. Në rregull. Unë do ju bëj një parashtrim, domethënë, do
20 ju them diçka dhe pastaj duhet të komentoni këtë që po them
21 unë, në qoftë se do sugjerohej që në fakt ti, Skënder Hoti dhe
22 Fehmi Kryeziu i keni arrestuar Cen Deskun dhe Jakup Kastratin,
23 mbështetur në urdhrat e eprorëve tuaj në njësitin Lumi, ti çka
24 do thoje për këtë gjë?

25 PË. Po nuk kanë qenë urdhra të njësimit Lumi. Kjo ka qenë

1 rastësi, i nderum, që na ka ndodhun neve. E rastit ishte.

2 PY. Në qoftë se thuhet ose sugjerohet që ti tani po thua që

3 kanë qenë dy ushtarë anonim ata që i kanë marrë këta dy

4 persona dhe që ti ke qenë personi i vetëm që e ke parë këtë me

5 sytë tuaj dhe ti thua që kjo nuk është e vërtetë dhe është një

6 përpjekje për të fshehur përfshirjen tuaj si dhe përfshirjen e

7 eprorëve të tjerë të njësitit Lumi, çfarë kishit për të thënë

8 ju për këtë sugjerim?

9 PË. Nuk ka pas --

10 PY. Cili do ishte qëndrimi juaj lidhur me këtë?

11 PË. Nuk ka pas përfshirje të eprorëve Lumi, asnjërit. Nuk ka

12 pas përfshirje në arrestimin e tyre të policisë ushtarake,

13 mesa di unë. Vetëm momenti jonë që jemi takuar rastësisht aty

14 edhe i kemi ftu ata që po u thirrin dy persona. Kjo ka qenë e

15 tëra.

16 PY. E kuptojmë. Ju faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje

17 tjera për ju.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kam pyetje për këtë dëshmitar.

19 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

21 z. Dixon.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje për këtë dëshmitar.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Unë kam pyetje për

24 dëshmitarin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Do bëjmë pushimin tani dhe do rifillojmë përsëri në orën
2 11.00, fillojmë me pyetjet tuaja ë orën 11.00.

3 Dëshmitar, do bëjmë një pushim prej 30 minutash tani. Do
4 ju kërkoja të mos flisnit me askënd lidhur me dëshminë tuaj
5 dhe tani mund të dilni nga salla e gjyqit në shoqërinë e
6 Asistentes.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
9 pushim deri në orën 11.30.

10 --- Pauza fillon në orën 10.55

11 --- Seanca rifillon në orën 11.30

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, ju
13 lutem silleni dëshmitarin në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

16 Alagendra tani është avokatja e z. Krasniqi dhe ajo ka disa
17 pyetje për ju. Dëgjojeni me vëmendje.

18 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë quhem Venkateswari Alagendra
21 dhe përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Shumë pak pyetje kam.

22 PË. Mirëmëngjes.

23 PY. Dëshmitar, ju e dini që Dragobili përdorej shpesh për
24 takime mes zyrtarëve amerikanë dhe anëtarëve të UÇK-së, apo
25 jo?

1 PË. Po.

2 PY. Në vjeshtën e 1998-s, atje ka qenë, pra, në Dragobil ka
3 qenë dhe KDOM-i amerikan, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Zyra amerikane në Dragobil përdorej për takime mes
6 përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe anëtarëve të UÇK-së, përfshirë
7 këtu dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, kam të drejtë?

8 PË. Po.

9 PY. Ti i ke thënë Prokurorisë që ndonëse ju ishit anëtar i
10 policisë ushtarake dhe ishit i vendosur në Dragobil, ju nuk
11 ishit përgjegjës për t'ju ofruar siguri anëtarëve të UÇK-së që
12 vinin aty në Dragobil për t'u takuar me ndërkombëtarët,
13 kështu?

14 PË. Po.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Shohim në ekran materialin
16 me numër P1667.2, faqet 2 dhe 3, rreshtat 18 dhe 11 në faqen
17 pasardhëse, kjo është tek anglishtja. Në shqip faqja 2 dhe 3,
18 rreshtat 18 dhe 7, 7 i takon faqes tjetër.

19 PY. Dëshmitar, lexoje atë që fillon nga rreshti 18 e poshtë
20 te shqipja, lexoje vetë ju lutem. Dhe kur të mbarosh na thuaj
21 që të kalojmë tek faqja tjetër.

22 Kalojmë tek faqja tjetër, Dëshmitar, e lexuat?

23 PË. Po.

24 PY. Tek rreshti 7 mund të përfundoni leximin.

25 PË. Po.

1 PY. Përfunduat? Okej.

2 PË. Po.

3 PY. Të kujtohet që në 2019-n të kanë pyetur a ke parë ndonjë
4 zyrtar të lartë të UÇK-së në Dragobil, jo domosdoshmërisht
5 vetëm ditën që u arrestua Desku dhe Kastrati, po gjatë gjithë
6 kohës që keni qenë në Dragobil? E pe këtë pjesën në
7 intervistë?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe ti ke thënë që:

10 "..."nuk qëndronim rregullisht në Dragobil. Një herë më
11 informuan që kishte qenë Jakup Krasniqi atje. Sa për raste të
12 tjera, nuk e di. Nuk e di. Nuk më kujtohet."

13 Kështu?

14 PË. Po, kështu ka qenë.

15 PY. Javën e kaluar gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë,
16 ti ke thënë kështu - dhe për procesverbal, bëhet fjalë për
17 materialin që ka numër 122860, paragrafi 5 - dhe është
18 regjistruar sikur ke thënë kështu që:

19 "Nuk ke parë asnjë anëtar të Shtabit të Përgjithshëm në
20 Dragobil. Po sipas shokëve tuaj, Jakup Krasniqi, ka qenë në
21 Dragobil për takime."

22 Të kujtohet që e ke thënë këtë?

23 PË. Po. Po.

24 PY. Që të jemi të qartë, Dëshmitar. Ti me sytë e tu nuk e ke
25 parë Jakup Krasniqin në Dragobil. Po këtë e ke dëgjuar nga

1 shokët e tu.

2 PË. Po.

3 PY. Ata të kanë thënë ty se ka ardhë për takime në Dragobil?

4 PË. Po, kështu ka qenë.

5 PY. Atë ditë, ditën konkrete kur thoni ju erdhën dy ushtarë

6 dhe kërkuan Cen Deskun dhe Jakup Kastratin, atë ditë Jakup

7 Krasniqi nuk ka qenë në Dragobil, apo jo?

8 PË. Jo. Jo, jo, nuk di për këtë informacion.

9 PY. Faleminderit.

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

12 znj. Alagendra.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje

14 plotësuese nga Prokuroria?

15 Z. PACE: [Përkthim] Po, shkurtimisht.

16 Pyetje vijuese nga z. Pace:

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 PY. Dëshmitar, sot kur filluam dëshminë, Avokati i z. Thaçi

19 të pyeti nëse i kishe thënë ti z. Desku dhe z. Kastrati se i

20 kërkonin dy ushtarë që të shkonin dhe të bënë një bisedim, ti

21 u përgjigje dhe the:

22 "Nuk më kujtohen detalet, po nuk kemi fol."

23 Pyetja e parë që kam unë është kjo, Dëshmitar: A është e

24 saktë që ju personalisht nuk keni biseduar me z. Desku dhe z.

25 Kastrati kur i morën nga Dragobili atë ditë?

1 PË. Jo, nuk kemi biseduar.

2 PY. Mesa di ti, atë ditë Skënder Hoti apo Fehmi Kryeziu kanë
3 biseduar me z. Desku dhe z. Kastrati, kanë fol me ta?

4 PË. Jo, asnjëri. Mesa e di unë asnjëri.

5 PY. A e mban mend që i ke thënë javën e kaluar Prokurorisë se
6 ty të kujtohet që Fehmi Kryeziu foli me z. Desku dhe z.

7 Kastrati kur dolën nga takimi dhe ju tha se duhet të
8 takoheshin me anëtarë nga Shtabi i Përgjithshëm?

9 PË. Po. Fehmiu që i thirri ju tha që "Duhet të shkoni te qëta
10 dy ushtarët që kanë ardhur për t'ju marrë". Asgjë tjetër nuk
11 ka fol me ta.

12 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

13 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 z. Pace.

16 Pyetje nga Trupi Gjykses:

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Krasniqi.

18 Besoj më dëgjoni mirë?

19 PË. Po, mirë.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Krasniqi, faleminderit
21 për dëshminë që ke dhënë deri tani. Po edhe Gjykatësit kanë
22 disa pyetje për ju sepse ka disa aspekte që kanë nevojë për më
23 shumë sqarim edhe unë do të filloj me këto pyetje.

24 Në intervistën që i keni dhënë Prokurorisë - Pjesa 2 e
25 intervistës suaj që ka tashmë numrin P01667.2, faqja 5,

1 rreshti 7 dhe 13 - keni thënë si në vijim:

2 "Kur doli Jakupi dhe Ceni, unë pashë që ata ishin të dy
3 arsimtarë, intelektualë. Ne menduam se ata po i thërrisnin që
4 të konsultoheshin me ata, t'ju merrnin ndonjë këshillë. Ne nuk
5 menduam që ushtarët do t'i arrestonin ata, ne menduam se po i
6 thërrisnin që t'ju merrnin ndonjë këshillë."

7 Pyetja e parë është kjo: Çfarë këshille menduat ju se
8 mund të jepte z. Desku, z. Kastrati?

9 PË. Po ai këshillë, nuk e di çfarë këshille po tu mendu në
10 atë aspektin që do të bisedojnë me ta si arsimtarë që ishin.
11 Ku mund ta dija unë çka të bisedonin ata.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kujt duhet t'ia jepnin
13 këto këshilla, me kë duhet ta bënë këtë bashkëbisedim? Sipas
14 jush në atë kohë?

15 PË. Po në atë kohë, ku di unë me kë donin të bisedonin edhe
16 për çfarë arsye të bisedonin ata.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje tjetër lidhur
18 me atë që i keni thënë Prokurorisë në 2019, kjo ka lidhje me
19 intervistën. Domethënë, është Pjesa 2 e intervistës P01667.2,
20 faqja 7, rreshtat 12 deri në 21. Ju keni thënë kështu:

21 "...pasi i morën, pas nja dy ditësh, na informuan se Cena
22 dhe Jakupi ... ishin arrestuar."

23 Prokurori ju pyeti:

24 "Po kush ju informoi?"

25 Dhe ju i jeni përgjigjur:

1 "Na informuan njerëzit, na thanë që e kanë marrë Jakupin
2 dhe Cenen."

3 Tani unë po ju pyes: Kush ju informoi? Kush ishin këta
4 persona që keni përmendur ju në intervistën me ZPS-në?

5 PË. Po kryesisht ishin familjarët e tyre që interesoheshin
6 për ta.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, familjarë të z.
8 Kastrati dhe të z. Desku ju thanë ju që ata të dy janë
9 arrestuar, këtë po thoni?

10 PË. Po, kështu qëndronte. Kështu flitej.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po a ju treguan nga e kishin
12 mësuar ata që ishin arrestuar Z. Kastrati dhe z. Desku, nga e
13 mësuan anëtarët e familjes?

14 PË. Nuk e di.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në të njëjtën faqe të
16 transkriptit, pra, të intervistës me ZPS-në keni thënë në 2019
17 se:

18 "...pas disa ditësh na informuan se kishin shkuar atje
19 lart ... tek shtabi për intervistë."

20 Dhe pyetja që kam unë është: Kush ua tha, ku e dini ju,
21 nga e dini ju që shkuan atje lart tek shtabi ata për një
22 intervistë?

23 PË. Po familjarët e tyre.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje tjetër. Kjo
25 ka lidhje me seancën përgatitore me Prokurorinë - e kam fjalën

1 për materialin që mban numrin P01668, Shënimi Përgatitor numër
2 1, e më konkretisht është paragrafi 19 i këtij shënimi - ku
3 sipas të cilit ju keni thënë, ose e konfirmuat dhe sot, që ju
4 nuk keni qenë i pranishëm atje në cilësinë e ndonjë zyrtari
5 kur u liruan z. Desku dhe z. Kastrati. Ju rastisët të ishit në
6 Dragobil dhe shkuat atje të shihnit lirim të tyre. Këtë
7 pyetje ua bëri dhe Avokati i z. Thaçi sot.

8 Tani unë kam një pyetje për një fjali tjetër, që nuk ua
9 tregoi njeri, ku thuhet se ju u gëzuat kur patë që z. Kastrati
10 dhe z. Desku u liruan.

11 Unë tani po ju pyes pse u gëzuat ju? Pse ju bë qejfi ju
12 që lirua z. Desku dhe z. Kastrati?

13 PË. Mu bë qejfi se më akuzojshin ju i keni arrestu, e jo
14 fjalë. Se dhe ne kemi familje. Dhe ne kemi fëmijë. Nuk kemi
15 dëshirë që fëmijëve tanë t'u thotë dikush që baba juaj ka
16 arrestu këtë apo atë person. Jemi gëzu kur janë liru. Pse jo?
17 Unë i kam gjashtë fëmijë, e kam qejf me jetu edhe ata të lirë
18 si të gjithë fëmijët e të tjerëve. Për atë jam gëzu që janë
19 liru.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A patën ndonjë ndjenjë faji
21 ju që ishit -- që ishit i përfshirë në atë ngjarjen që
22 përfundimisht çoi, po e themi, në ndalimin e tyre? Në ndalimin
23 e z. Desku dhe z. Kastrati?

24 PË. Jo, aspak faj nuk patëm ne.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nuk u ndjeve fajtor,

1 nuk pate ndonjë ndjenjë faji?

2 PË. Jo, aspak. As sot as kurrë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Na e trego dhe një herë,
4 atëherë, në qoftë se ti s'kishe asnjë ndjenjë faji pse t'u bë
5 qejfi? Ti the që kishte gjashtë fëmijë. Ku, çfarë lidhje
6 kishte kjo?

7 PË. Po kjo lidhje se u flitke në popull që Demush Krasniqi,
8 Skënder Hoti edhe Fehmi Kryeziu i kanë arrestu e tani ishte jo
9 e mirë ajo e jona. Se s'dijshmi kurrfarë qëllimi ndaj tyne.
10 Edhe u gëzuam kur u lirutën. Pse jo?

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kjo ishte
12 pikërisht pyetja ime, z. Krasniqi. Po çfarë mendove ti se mund
13 t'u ndodhte atyre? Çfarë mendove se do t'i ndodhte z. Desku
14 dhe z. Kastrati kur i morën sepse më vonë ti mësove nga
15 familjarët e tyre se ishin arrestuar? Ty çfarë të shkoi nëpër
16 mend, çfarë mund t'ju ndodhte atyre?

17 PË. Jo, s'kam mendu që ju ndodh asgjë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e radhës lidhet me
19 atë që i keni thënë Prokurorisë gjatë seancës përgatitore e
20 cila është hedhur në Shënimin Përgatitor numër 2 dhe të
21 njëjtën pyetje ju bëri dhe Avokatja e z. Krasniqi në
22 paragrafin 5. Bëhet fjalë për paragrafin 5 të Shënimit
23 Përgatitor numër 2. Dhe po ju lexoj nga paragrafi:

24 "Dëshmitari 03885", që jeni ju, "nuk ka parë asnjë anëtar
25 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Dragobil. Sipas

1 shokëve të dëshmitarit, Jakup Krasniqi ka qenë në Dragobil për
2 takime.”

3 Tani unë kam këtë pyetje: A e dini ju në çfarë roli erdhi
4 z. Krasniqi në Dragobil, në çfarë cilësie?

5 PË. Po ku ta di unë çfarë cilësie ka ardh Jakup Krasniqi aty.
6 Mbasi unë nuk kam qendru rregullisht aty.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Shokët nuk të treguan se
8 çfarë cilësie pati ai, në çfarë cilësie erdhi ai në Dragobil
9 për këto takime?

10 PË. Jo.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po çfarë roli apo pozite
12 kishte z. Jakup Krasniqi në UÇK gjatë luftës e dini ju këtë?

13 PË. Jo, nuk e di.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, ju nuk e dinit që
15 ai ishte zëdhënësi i UÇK-së gjatë luftës?

16 PË. Po nuk kisha informacione unë se ishmi në një zonë atje
17 ka rrethi i Kievës, Bubavecit. Ku të dija unë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po për z. Thaçi e dinit ju
19 çfarë roli apo pozite kishte në UÇK?

20 PË. Jo.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jemi të qartë, nuk po
22 ju pyes çfarë dinit asokohe. Po tani e dinit, tani, domethënë,
23 e di ti çfarë pozite ka pasur ai, në qoftë se ka pasur ndonjë?

24 PË. Po tani tash të flitet për Hashim Thaçin në këtë kohë, i
25 cili -- ne jetojmë në Kosovë të lirë. Është, nuk ka shqiptar

1 që s'e din rolin e Hashim Thaçi pas lufte. Ne jemi krenar me
2 të. Jemi krenar me emrin e tina. Na ka shpallë pavarësinë. Ka
3 qenë prej Rambujesë e kënejnës, tani dihet veç vepra dhe puna e
4 Hashim Thaçit për popullin shqiptar të Kosovës. Edhe bile ne
5 edhe fëmijët që lindin u vëmë emrat e Hashim Thaçit në Kosovë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Çfarë roli ka
7 pasur, pra, çfarë pozite?

8 PË. Po tash pas lufte jam informu. Në Rambuje e kam pa për
9 herë të parë në televizor Hashim Thaçin. Ka qenë drejtori
10 politike.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, gjatë luftës ti
12 nuk e ke ditur që mendohej se Hashim Thaçi ka qenë përfaqësues
13 politik i UÇK-së?

14 PË. Jo, pas lufte. Pas Rambujesë jam informu.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur të informuan pas
16 Rambujesë, atëherë e mësove ti që ai ishte kryeministri i
17 Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në 1999, këtë e kisha
18 dëgjuar?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po dy të akuzuarit e tjerë,
21 z. Kadri Veseli? E ke ditur çfarë roli apo pozite ka pasur ai
22 gjatë luftës?

23 PË. Jo.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të njëjtën pyetje e kam për
25 z. Selimi, z. Rexhep Selimi.

1 PË. Jo, s'e kam njoft as Rexhën.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani kam një pyetje që
3 lidhet me provën materiale P01671. Do i lutesha Sekretares që
4 dokumentin ta vendosë në ekran. Faleminderit.

5 Z. Krasniqi, sot ju bënë pyetje për këtë dokument, ua
6 bëri pyetjet Prokurori. Dhe nga sa kuptova unë, ju thatë se
7 keni marrë, ju është tërhequr vëmendja ose jeni qortuar se nuk
8 keni qenë i pranishëm, kështu?

9 PË. Po.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do të doja tani të më thoni
11 kush ua tërhoqi vëmendjen për këtë ju që s'kishit qenë i
12 pranishëm?

13 PË. Po, sigurisht nga komandanti Sejdi Paqarizi. Se ne e
14 kishim familjen malit të Turjakës. Edhe kishin nevojë familja
15 për ushqim. Unë shpesh shkojsha, i vizitojsha familjen se
16 ishte vetëm nëna dhe gruaja me gjashtë fëmijë në male të
17 Turjakës dhe nuk kishte kushte. Me siguri atë ditë jam vonu
18 dhe për këtë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E ke vizituar familjen dhe
20 kur fillove të kryeje shërbimin në UÇK?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe atëherë të tërhoqën
23 vëmendjen apo më vonë?

24 PË. Po, ma vonë me siguri.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto qortimet apo kjo

1 tërheqja e vëmendjes në ç'formë ishte, çfarë ju bënë?

2 PË. Jo, po unë isha më i vjetri aty pi shokëve. Edhe po të
3 vonohesha unë, vonoheshin edhe të tjerët. Kështu që ish
4 rregull.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë e kuptoj, po unë dua të
6 di si, në ç'mënyrë, çfarë mase, për shembull, ju tërhoqën
7 vëmendjen me gojë? Ju dhanë ndonjë dokument me shkrim?

8 PË. Jo, kjo ishte vërejtje gojore.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përveç këtyre dy ushtarëve
10 që janë përmendur këtu tek numri 2 dhe 3, këta ushtarët e
11 tjerë po ashtu u është tërhequr vëmendja dhe ushtarëve të
12 tjerë që s'kanë qenë të pranishëm?

13 PË. Po ne ishim nga fshatrat. Unë isha nga Drenovci. Ekrem --
14 Burim Foniqi nga Llozica. Ekrem Gashi nga Vermica. Ju me
15 siguri nuk e -- këto fshatra janë kanë afër rrugës që ishte
16 Kievë, rruga Pejë-Prishtinë. Edhe deri shkojshmi na te shokët
17 ishte largësi. Fillonte moti me ujë, me llaç, me shi, kishte
18 vështirësi e jemi kanë vonu, për atë ishte arsyeja.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ushtarët e tjerë me
20 përjashtim të këtyre që përmende? Ose të paktën dini ndonjë
21 rast tjetër ju kur u është tërhequr vëmendja ushtarëve?

22 PË. Jo, jo.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam dhe një pyetje tjetër
24 lidhur me diçka që keni thënë në deklaratën tuaj ose të paktën
25 sipas asaj që është hedhur në deklaratën tuaj në 2016, por

1 edhe sot e përmendët gjatë pyetjeve që ju bëri Mbrojtja e
2 Thaçit. Ose më saktë do të vendosim në ekran deklaratën.

3 Është prova materiale me numër P01666, nëse nuk e kam
4 gabim numrin. Faqja 3. Faleminderit.

5 Do lexoj fjalinë, do përpigemi ta gjejmë dhe në shqip
6 cilën faqe do lexoj. Anglishtja fillon me këtë:

7 "Ky person më thirri nga vetura dhe tha që" -- është
8 këtu.

9 "Dikush prej shokëve ka hyrë brenda në takim ka thirrur
10 Jakupin dhe Cenen. Ky person" -- a ja e gjeta.

11 "Unë personin ushtarak [E pakuptueshme] që së bashku --
12 është kjo fjalia këtu në shqip. "Ky personi me uniformë nga
13 vetura në të cilin hyri Cena dhe Jakupi na tha që Cena dhe
14 Jakupi kanë me dhënë një deklaratë në Shtabit të Përgjithshëm
15 në Berishë".

16 E gjete fjalinë?

17 "Ky personi me uniformë nga vetura", fillon fjalia.

18 PË. Po, e gjeta.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani në qoftë se nuk e kam
20 unë gabim, ti sot ke thënë që ky person nuk ua tha ju këtë
21 gjë? Duam ta kuptojmë pse është thënë në intervistën e 2016
22 kjo gjë që personi të ka thënë ty se z. Kastrati dhe z. Desku
23 duhet të shkonin të jepnin një deklaratë për takimin me
24 zyrtarët amerikanë? A mund të na e shpjegoni pse është thënë
25 këtu?

1 PË. Po kjo mund me thënë ose nga Fehmia ose nga unë që nuk po
2 më kujtohet që e kam dëgju bile që e ka thënë kështu. Po. Se
3 nuk kemi pas kohë të bisedojmë me ta.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ju kujtohet tani,
5 Dëshmitar?

6 PË. Jo. Jo, s'më kujtohet.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Mikrofoni çaktivizuar].

8 [Përkthim] Po thoni që nuk ju kujtohet tani apo po thoni
9 që nuk ia keni thënë këtë gjë Speciales së Kosovës në vitin
10 2016?

11 PË. Vallaj nuk më kujtohet. Nuk e di.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Vërej, z. Krasniqi, që në
13 versionin në anglisht thoni dhe këtë e keni thënë në faqen
14 051760 - do i kërkoja Sekretares të kaloj tek kjo faqe.

15 Në fund fare në anglisht aty thuhet:

16 "Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar për dëshminë.

17 "Procesverbali më është lexuar dhe unë po hedh
18 nënshkrimin pa asnjë koment."

19 Ndërkohë që te versioni në shqip është dhe nënshkrimi
20 juaj. Nënshkrimi juaj gjithashtu lexohet në çdo faqe që e
21 konfirmuat edhe më herët sot.

22 Pra, a ju është lexuar procesverbali me zë në vitin 2016,
23 a është e vërtetë që ju e keni nënshkruar pa bërë asnjë koment
24 e asnjë vërejtje lidhur me të?

25 PË. Po, po, më është lexu.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ky është nënshkrimi juaj,

2 apo jo, Dëshmitar --

3 PË. Po.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] -- tek kjo faqe?

5 Faleminderit. Nuk kam pyetje tjera.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

7 Mettraux.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi

9 Smith.

10 Dhe mirëdita, Dëshmitar.

11 PË. Mirëdita.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që ju pyeti

13 Avokati i z. Thaçi lidhur me Gani Krasniqin më herët sot? E

14 dëgjuat apo jo? Në qoftë se nuk e dëgjuat mund t'jua përsëris?

15 PË. Po, urdhnoni.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që Avokati i

17 z. Thaçi ju bëri pyetje lidhur me Gani Krasniqin, ju kujtohet

18 kjo?

19 PË. Po, më bëri pyetje.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mesa keni dijeni ju, Gani

21 Krasniqi a ka pasur ndonjë rol apo a ka luajtur ndonjë rol në

22 ndalimin dhe arrestimin e z. Desku dhe Jakup Kastratit?

23 PË. Jo, kurrfarë roli nuk ka pas Gani Krasniqi në marrjen e

24 Cenit dhe Jakupit.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Isni Kilaj ka pas

1 ndonjë rol?

2 PË. As Isni Kilaj nuk ka pas asnjë rol për marrjen e Jakupit
3 dhe Cenit.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ne na është sugjeruar që
5 Gani Krasniqi mund të ketë dashur të mbrojë Jakup Kastratin. A
6 keni dijeni ju lidhur me këtë gjë, dini ndonjë gjë lidhur me
7 këtë?

8 PË. Jo, jo, nuk kam dijeni.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Personalisht ju vetë apo
10 Fehmi Kryeziu, Skënder Hoti, a keni dashur që të hidhni baltë
11 mbi z. Kastrati duke e arrestuar atë?

12 PË. Jo.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Personalisht ju vetë apo
14 mesa keni dijeni juve, Fehmi Kryeziu ose Skënder Hoti, a kanë
15 pasur ndonjë mosmarrëveshje personale ose a kanë pasur ndonjë
16 mëri me z. Desku ose me z. Kastrati?

17 PË. Jo, me asnjërin.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
20 Gaynor.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

22 Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje
24 plotësuese nga Prokuroria apo nga palët?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, faleminderit, z. Kryegjykatës.

1 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic:

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, sapo ju pyeti Gjykatësi Mettraux në qoftë se
4 Gani Krasniqi ka luajtur ndonjë rol në arrestimin e Cen Deskut
5 dhe të Jakup Kastratit dhe ju u përgjigjët "jo". Nga e dini ju
6 këtë gjë?

7 PË. Po nuk kam -- kur nuk ki informacion për këtë edhe thu
8 jo. Nuk e di.

9 PY. Për shkak të faktit që ju nuk keni informacion lidhur me
10 këtë nuk do të thotë se është e vërtetë, apo jo, ose e vërtetë
11 ose e pavërtetë nuk do të thotë në qoftë se nuk keni
12 informacion, kështu?

13 PË. Po kur nuk kam informacion edhe them jo. Nuk e di. Unë nu
14 besoj që kur thuhet "nuk e di" edhe "jo" si shkurt.

15 PY. Pra, përgjigja për pyetjen e Gjykatësit Mettraux, pra,
16 për pyetjen në qoftë se Gani Krasniqi ka luajtur ndonjë rol i
17 takon që përgjigja jua j duhet të kishte qenë që: Nuk e di.
18 Kështu?

19 PË. Nuk e di.

20 PY. E njëjta vlen edhe lidhur me pyetjen që ai ju bëri për
21 Isni Kilajn. Ju thatë që ai nuk ka pas asnjë rol, domethënë,
22 përgjigja duhet të jetë që ju nuk e dini në qoftë se ka luajt
23 ndonjë rol ai, apo jo, kështu?

24 PË. Jo, nuk e di.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Edhe një çast, ju lutem.

Dëshmitari: Demush Krasniqi (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 75

1 PY. Nëse Gani Krasniqi ose Isni Kilaj kanë pas një bisedë me
2 Enver Hotin lidhur me Jakup Kastratin ose Cen Deskun, ju nuk
3 keni nga ta dini këtë, apo jo?

4 PË. Jo, nuk e di.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Znj. Alagendra.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo nuk
10 kam pyetje. Por në transkript shkruhet Krasniqi në vend të
11 Kastratit. Do të doja që të rishikohet kjo pjesa.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jam i sigurtë
13 që do korrigjohet. Mund ta kontrolloni dhe nesër për të parë
14 në qoftë se ka ndryshime apo jo.

15 Ndonjë person tjetër ka ndonjë pyetje tjetër plotësuese
16 nga palët?

17 Në rregull.

18 Dëshmitar, tani kemi përfunduar me dëshminë tuaj. Ju
19 falënderojmë që ishit me ne sot. Mund të largoheni nga salla e
20 gjyqit dhe nuk keni më detyrim që të jepni dëshmi përpara
21 nesh. Faleminderit që ishit me ne sot.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Rowan.

25 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të

1 trajtoj një çështje administrative përpara sesa ta mbyllim
2 seancën sot.

3 Kemi pasur, kemi qenë në kontakt me NJAGJ-në që ka të
4 bëjë me zëvendësimin e një përkthimi të një prove.

5 Do i kërkonim Trupit Gjykses, nëse është e mundur, që të
6 zëvendësojë dokumentin U001-8394 deri në U001-8399-ET me këtë
7 dokument që mban numrin ERN U001-8394 deri në U001-8399-ET e
8 Rishikuar. Nuk mund të trajtojë historikun procedural sa i
9 takon kësaj prove materiale, megjithatë me pak fjalë kërkoj
10 zëvendësimin e përkthimit që ka qenë përkthim i ofruar
11 fillimisht nga ZPS-ja. Kështu që thjesht kërkojmë që të bëhet
12 zëvendësimi.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Ka ndonjë kundërshtim?

15 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim që të
16 zëvendësohet përkthimi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Atëherë do zëvendësohet prova.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Sa për sqarim, besoj që
20 bëhet fjalë për zëvendësimin e përkthimit për provën 2D14, sa
21 për të qenë të gjithë në të njëjtën linjë.

22 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Po. Është numri i saktë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Mbaruam për sot. Për nesër nuk kemi dëshmitar. Do të
25 rivijojmë më tej të mërkurën në orën 9.00. Do të vazhdojmë me

1 dy dëshmitarët e tjerë deri të enjten pastaj.

2 Në rregull. Në qoftë se nuk ka ndonjë gjë tjetër nga
3 palët, e mbyllim seancën këtu dhe do të rifillojmë përsëri të
4 mërkurën në orën 9.00 të mëngjesit.

5 --- Seanca mbyllet në orën 12.11

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25